


NAUN KULE

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-7
K 98



TREGIME DHE
SKICA
HUMORISTIKE


834-7

K 98

NAUN KULE

DOLLIA E FUNDIT

Tregime e skica humoristike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

METAMORFOZA E DHËNDRIT



Kam kohë që jam larguar nga fshati i lindjes. Por as puna e jeta që bëj në një qytet të largët dhe as koha e gjatë që ka kaluar që atëherë, nuk kanë mundur të më shlyejnë nga mendja ato kujtime e mbresa që më lidhin aq fort me fshatin tim, me bashkëfshatarët e mi. Përkundrazi. Sa më shumë kohë kalon, aq më shumë mallohem. Bile ndonjëherë, kur bisedoj me shokët e mi bashkëfshatarë, më vjen rëndë e më duket sikur thonë: «Pse na ike, o Koçi? Pa shiko ç'kemi bërë e ç'po bëjmë!...» Sidoqoftë, ata e dinë dëshirën time. Ndaj, sa herë gjej rast e kohë, marr fëmijët e ngjitem në fshatin e lindjes. Kështu bëra edhe këtë herë.

Treni ishte gati për t'u nisur dhe unë zura radhën në biletarinë e stacionit. Dy-tre vetë para meje ishte Andoni. Me biletat në dorë u nisëm drejt vagonit.

— Këtej, — më tha Andoni, — se kam edhe Vitën me dajën e saj. Ishim mbrëmë për darkë te djali i dajës që është oficer në qytet. E njeh? — më pyeti ai.

— E njoh, — i thashë. Është Sokrati, apo jo?

— Iu lutën dajës të rrinte disa ditë në qytet, — vazhdoi Andoni, — po mezallah se iu mbush mendja.



«Kam edhe unë punët e mia në fshat», u tha. «Ja, po vjen anës të prishet koha dhe me shokët e lamë që të vemë në vargje duhanin e mbledhur». Dhe erdhi që erdhi me ne.

U takova me Vitën e me dajën e saj dhe u ulëm bashkë. Me Vitën e Andonin jemi moshatarë. Kur takohen moshatarët, që kanë kaluar bashkë fëmijërinë e një pjesë të rinisë, sado e gjatë të jetë rruga, nuk të duket gjë, sepse kujtimet rrjedhin vetë, duke shtyrë njëri-tjetrin për të dalë në dritën e kujtesës dhe koha ikën pa u kuptuar.

Treni shpejtonte drejt fshatit tonë. Genti, djali im i vogël numëronte stacionet që kishin mbetur dhe mezi priste. Daja i Vitës e shikonte dhe qeshte i kënaqur. Të gjithë bisedonim dhe qeshnim.

Por, megjithëse merrja pjesë në gëzimin dhe çiltërsinë që mbushnin zemrën e bashkëfshatarëve të mi, mendja më rrihte larg, shumë larg, më ngacmonte kujtesën një ngjarje që dikur pat bërë shumë bujë në anët tona.

«Ç'bën koha! — mendoja. — Ndodh që njeriu merr në jetë një plagë dhe i duket vetja përfundimisht i humbur. Po, po! Kështu kam menduar ndoshta edhe unë vite më parë, kur ndodhi kjo që do t'ju tregoj. Kështu mendoja atëherë për Vitën... Por jo! Koha, jeta, njerëzit e fortë e të rinj, janë shumë më të fuqishëm se çdo plagë, sado e pashërueshme që të duket. I fortë nuk është vetëm ai që s'rrëzohet asnjëherë në rrugën e gjatë të jetës. Zotësi e madhe është që, edhe kur rrëzohesh, të gjesh te vetja forca për t'u ngritur përsëri e menjëherë. E pra Vita u ngrit! Domethënë qenka e fortë, shumë e fortë! Ja, ajo qesh e bisedon tani me dajën njëlloj si me mua që më ka shok, si me Andonin që e ka butrë. Por

kushdo që njuh plagën që i ka shkaktuar ai dajë mbesës së tij, kurrë s'do ta besonte se ata mund të qëndronin përballë njëri-tjetrit.

*
* *

Ikja e nuses nga shtëpia e babait, duke fshirë lotët, është e lashtë, sa dhe vetë dasma. Po ç'është e vërteta, edhe pse fshin lotët, mendja të thotë se zemra i këndon, se «kush u martua e s'u gëzua!» Kështu menduan edhe krushqit e Tunit, kur panë se nusja po vonohej të dilte. Ama dasmën, në të vërtetë, e tundi Tuni! Strumbullari i gjithë punëve në këto raste ishte daja mustaqelli. Dhe pavarësisht nga sa ndodhte në dhomën e nuses, ai vazhdonte sipas programit të tij. Miqësia e farefisi, të ngopur e të velur deri në grykë, duke u mbajtur te njëri-tjetri, po bëheshin gati të përcillnin nusen. Dhëndrin s'po e mbannte vendi. Tani ai po jetonte minutat më të vështira i kredhur në atë kaos dasmorësh, këngësh, vallesh sharjesh e të thirrurash, të cilat i gjëmonin në vesh e në tru si një këmbanë me shumë tinguj, dhe në shqetësimet e veta që i kishin lindur jo pa arsye.

Që kur e kuptoi se pritja e kaloi kufirin e zakonshëm dhe krushkut të parë erdhi e i kërkoi ndjesë për vonesën dasmori mustaqelli (që dihej se kryente funksione me rëndësi në shkëmbimet mes dy palëve), dhëndrit i shkuan mornica në trup dhe u zbeh në çehre. Ata që e vunë re këtë shqetësim të tij, menduan se i vinte keq për nusen, e cila s'po shkëputej dot nga prindërit. Por e vërteta që krejt ndryshe.

Dhëndri mendohej e priste me sytë e ngulur te dera mos shihte fustanin e bardhë, për të cilin kishte

rrahur e kthyer përmbys gjysmën e qytetit. I gjori dhëndër! Sikur ta dinte se ai fustan akoma nuk ishte zënë me dorë nga nusja dhe se ajo, dy-tri herë ishte matur të dilte e t'ia hidhte surratit, me siguri do të kishte ikur me vrap!

Megjithatë daja mustaqelli nuk ishte nga ata burra që dorëzohen lehtë. Sapo u fut në dhomën e nuses, u duk sikur çdo gjë u bë zap. Vërtet që ai ishte daja i saj, po një dajë, që, nuk ta fal llafin, edhe sikur ta kesh thënë në gjumë, përçart.

— Hajde, çohuni! — iu kërcënua grave. — Për pesëmbëdhjetë minuta të ma nxirrni nusen në oborr, qartë?!

Duke dalë ua bëri me kokë edhe dy grave të tjera, që t'i hynin së njëjtës punë për të ndihmuar shoqet.

Më në fund dhëndri u çlirua nga ankthi, që e kishte zënë në grykë si ngërçi, kur pa dajën, i cili, pasi vuri paksa buzën në gaz, i thirri krushkut të parë:

— Gati, krushk? — Dhe bëri me kokë nga dera për të treguar se po dilte nusja. Këngët e ahengu që kishin pushuar pas gjithë asaj pritjeje, sikur u zgjuan menjëherë dhe filluan avazin. Pa mbaruar kënga *Ç'ke moj zoge, që po qan*, një grup tjetër grash, që ishin më afër dhëndrit e krushkut të parë, ia morën këngës. *Sa e bukur na ka dalë nusja*. Mirëpo nusja s'po dilte që s'po dilte! Ndërsa kënga vazhdonte duke i numëruar: *dhëmbët si inchi, sytë si ulli, vetullat gajtan...*, ajo nuk po dukej të dilte nga dera, drejt së cilës ishin ngulur dhjetëra sy dasmorësh; sy të kuq, të buhavitur, tërë rremba.

Nusja tani e kishte mbledhur veten. Daja u fut përsëri në dhomën e saj si një bishë e egërsuar, me

sy e hundë të skuqur. U ul ta rrëmbente e ta shtynte përjashta, por qe vonë. Tuni ishte në këmbë, pranë së bijës. Ndjenja prindërore pat zotëruar më në fund tek ai, më shumë se sedra dhe zakoni për t'i bërë qejfin mikut të shtëpisë. Tuni rrinte në këmbë dhe dëgjonte Vitën që po i thoshte:

— Të thashë baba! T'u luta ty e të gjithëve: mos u nxitoni për dasmën! Por ju s'më dëgjuat; dëgjuat dajën. Që pa ftuar miqësinë ju thashë të sqarohej më parë gjithçka thuhej për atë njeri; por ju edhe këtë punë ia besuat dajës... Gjithçka thoshte për të fshati, i shkruan edhe Donika në letër!...

Duke folur ajo shtrëngonte në dorë një zarf të zhubravitur.

Naja, sekretarja e rinisë së kooperativës, që po rrinte në këmbë pranë Vitës, pohonte me kokë dhe hidhte sytë herë pas here në fytyrën e murrëtyer e të menduar të Tunit.

Ditë më parë, Tuni, i bindur në vendimin e së bijës, kishte dashur të njoftonte miqësinë e krushkun se dasma do të shtyhej. Por i kunati dhe e shoqja e kishin bërë të tërhiqej nga ky mendim, duke e quajtur si turpin më të madh. Megjithatë ai ishte me të bijën. Që në fillim fare, pa qejf e pati, po se si ia prishi mendjen ai mustaqelliu me atë palo doktor nga qyteti. Përpara se të dilte kjo mesele, i kishin ardhur në vesh ca fjalë për dashurinë e Vitës së tij me Andonin, çunin e Themiu. Dhe ç'është e vërteta, ia kishte qejfi atë djalë, aq sa edhe krushqinë me bashkëfshatarin e tij, Themiu. Mirëpo ndryshe ia vërtiti rrotën mustaqelliu nga qyteti. Dhe ja tani: krushqit presin përjashta, kurse nusja bisedon me sekretaren e rinisë, duke i përsëritur vendosmërinë e saj, se ajo kurrë nuk kishte pranuar e

kurrë nuk do të pranonte të bëhej gruaja e një njeriu që as e kishte parë ndonjëherë.

— Qëndrimi yt në këtë dasmë do të jetë një mësim i mirë për shumë të tjerë!... i pëshpëriti Naja. — Ne ta kemi thënë si rini dhe po ta themi: Nuk do të të mungojë kurrë përkrahja jonë.

Daja i Vitës mori Tunin zvarrë për krahu, mori edhe të shoqen e Tunit, i shpuri në konakun tjetër e filloi të grindej me ta si ndonjë i çmendur:

— Me pahir nuk jepet nusja, or ti, mik! — iu përgjigj Tuni kërcënimeve të tij.

Në konakun e të ftuarve vazhdonte avazi i një kënge të zvargur grash. Krushqit po e humbnin durimin. Sytë e tyre filluan të kryqëzoheshin me ata të krushkut të parë, ndërsa ai u shkelte syrin, u kafshonte buzën dhe i qortonte në heshtje për mungesën e durimit. Dhëndrit një fytyrë i ikte, një tjetër i vinte.

Më në fund, te dera, në vend të nuses, doli i ati.

— Nusja është e sëmurë! — i tha krushkut të parë me zë të lartë, sa ta dëgjonte edhe dhëndri. — Mund të vini e ta merrni më vonë!..

Kaq tha dhe u zhduk. Krushqit shikuan njëri-tjetrin në sy. I pari e kuptoi të vërtetën dhëndri, kurse të tjerët e kuptuan nga ai, kur e panë se si i pari fytyra ngjyrën e vdekjes. Disa nga krushqit po kërkonin me sy mustaqellium, por atij i ndihej vetëm zëri i çjerrë e i përvajshëm diku thellë dhomave:

— Më turpëruat përjetë!... Më nxitë faqen!...

Dhëndri pasi e mblodhi veten, u lëshua me vrull drejt taksisë, sikur ta ndiqte dikush për ta vrarë dhe vetëm atje do të gjente shpëtim. Pas tij rendën të gjithë ata që kishin ardhur për të marrë nusen.

Ndërkohë, në dhomën e nuses gratë hynin e dil-

nin të tronditura, duke ndukur faqet me thonj. Janaj Plisi, djali me të cilin e pat fejuar daja i saj Vitën, ishte një djalë qyteti, që nuk kishte lënë gjë pa bërë. Ai kishte qenë edhe në burg për matrapazllëqe, duke bërë synetllëke si xherah. Por edhe këto të zeza sikur të mos i kishte, Vita donte Andonin dhe kurrë nuk do ta këmbente dashurinë për të me asgjë, sado të përpiqej i ungji t'i prishte mendjen me bukurinë e të mirat që do të shihte në qytet.

*

* * *

Që atëherë ka rrjedhur shumë ujë. Shumë gjëra kanë ndryshuar; edhe njerëzit kanë ndryshuar shumë, ndër ta edhe daja i Vitës, të cilit i vjen turp tani t'ia kujtosh krushqinë që deshi të bënte dikur. Ja, puna e solli që pleqërinë ta kalojë në mes të këtyre fshatarëve, që dikur i mblodhi për dasmë e s'u nxorri dot nusen.

Kështu ndodhi. Djali erdhi me punë në fshat, me grupin e parë të punonjësve që shkuan vullnetarisht nga qyteti për në fshatin e tyre. Erdhi edhe ai. Dhe i duket sikur s'ka qenë kurrë në qytet. Se denbabaden fshatar ishte, por kishte ikur që pas Çlirimit me punë në qytet dhe për disa vjet na u bë qytetar.

— E ç'qytet, a derzi! — thotë tani sa herë vjen llafi. — Qytetarë a fshatarë sot njëlloj janë. Ku ka nder e punë, njeriu gjithnjë është mirë, është i gëzuar...

Treni vazhdon vrapin e tij ritmik për në stacionin tjetër. Ne kemi zbritur dhe ecim krah për krah njëri-tjetrit në kalldrëmin e fshatit. Daja i Vitës për-

gëzon djalin tim dhe vajzën e mbesës, të cilët, të zënë për dore ecin në rrugën e gjerë midis gjelbërimeve; ata me gëzimin fëmijor në sy e në buzë, kurse ai me shqetësimin në mendje dhe sytë të retë e murme, drejt perëndimit. Kthehet nga ne dhe i thotë Andonit:

— Po të bjerë shi sonte na prish ca punë për atë duhanin që kemi mbledhur...

DREJTORI IM ËSHTË NË HALL

Rrallëherë drejtori im gjen ndonjë çikë kohë që të bisedojmë bashkë. Ai thotë se shëndeti i ka marrë tatëpjetën qëkur shokët e seksionit e emëruan drejtor. Jo se drejtori im nuk është i zoti për këtë punë (këtë ai e ka treguar me fjalë e me vepra), por sepse detyra sjell detyrën... Prandaj, ai që drejton, për shembull, si drejtor, nuk ka asnjë arsye që të mos drejtojë, në të njëjtën kohë e po aq mirë edhe si kryetar, si përgjegjës, si sekretar, si propagandist etj., etj...

— Ata që mendojnë kështu s'janë shumë, — thotë drejtori. — Te ne për shembull është Zeneli me dy-tre shokë. Mirëpo ka edhe ndonjë tjetër që s'do t'ua prishë atyre dhe më lënë vetëm mua t'i drejtoj të tëra punët.

Kuptohet që ata s'e kanë të gjatë, mirëpo sa parë bën! Tani për tani ata e morën në qafë drejtorin tim, e katandisën në gjysmë njeriu; në tridhjetë kile burrë.

— Mosni, për nder! — mundohet drejtori t'i bindë se nuk i mban dot gjithë ata kunguj nën sqetull.

— Fshati ka plot djem e vajza të mira, me shkollë!
Nuk e bëj dot, more shokë!

— E bën ti, e bën! — ia priti Zeneli e ndonjë shok i tij. Se edhe ata kanë arsyet e tyre të forta! Ç'u duhet t'u hyjnë avazeve me ndonjë të ri a të re që s'merr erë nga ato punë dhe që t'i rrinë si dado mbi kokë e ta mësojnë edhe si bëhen formularët, evidencat e raportet! Jo, mor vëlla; ç'u duhet atyre ta blejmë belanë me para! Ndaj i bien më qafë drejtorit tim, i përmendin meritat e mëdha e sukseset që ka arritur, stazhin e gjatë në këto detyra dhe e propozojnë përsëri.

Pastaj për ata e për të gjithë drejtori im është i njohur nga të gjithë anët... Pse, kollaj e quani ju t'i hysh punës për të njohur e studiuar një tjetër nga të gjitha pikëpamjet? Më mirë atë që ka qenë se, sido që ta sjellë puna, je brenda. Kështu e rizgjedhin, e urojnë e ikin me mendjen të mbledhur. Ata shikojnë punën e tyre, drejtori im sulet e robtohet i ziu, t'i shohë e t'i ndreqë të gjitha nga një çikë. Mirëpo kjo është e pamundur. Vete në shkollë dhe s'di kujt t'i japë përgjigje më parë: mësuesve, nxënësve apo atyre të seksionit.

Para ca ditësh ata të seksionit të arsimit e kritikuan ashpër për mosrealizimin e disa detyrave. Dhe ai bëri autokritikë. Ç'të bënte? Kishin hak edhe ata. Kolegët e tij në shkollat e tjera i kishin përfunduar e flisnin bilbil; ai memec. Shokët flisnin dhe e kritikonin, ai tundte kokën dhe mërmëriste:

— Edhe ju hak keni, vëllezër! Dukeni që e mbani kurrizin drejt! Ju kanë ngarkuar aq, sa mbani. Të jeni në vendin tim, pa! S'e njihni ju shokun Zenel që, pa filluar mirë zgjedhjet, ngrihet e propozon:

— Shokun drejtor të zgjedhim them unë...! Ka drejtuar mirë, është djalë i pjekur, i dashur, i ditur...

«I trashë thuaj!... Si nuk arrita t'i bind një herë, xhanëm, se nuk e bëj dot! — thotë me vete. — Gjithnjë me të mirë ma kanë ngrënë kokën!...»

Edhe kur vete të shtëpi, drejtori im s'e ka më të lehtë.

— Burra ka fshati plot! — ia pret gruaja me sëpatën në dorë për të çarë dru; — me shkollë e me punë të mëdha, por kështu si ti, jo ama! — Dhe fillon t'i numërojë porositë e shumta që i dha kur iku në mëngjes. Ai e dëgjon dhe i duket sikur ia kanë thënë ato gjëra jo në mëngjesin e asaj dite, por një vit më parë...

— Sa herë bëhen zgjedhjet në fshat, lista e kandidataturës nuk ka asnjë vlerë nëse nuk kryesohet nga emri i drejtorit tim. Në fund ai ngrihet disi i revoltuar e i përmbajtur, u hedh zgjedhësve racionin e detyruar të buzëqeshjes, tashmë të njohur, si shenjë bindjeje e mirësjellje ndaj zërit të masës, pastaj bën betimin solemn se do të punojë ditë e natë, për të justifikuar besimin e tyre.

Dhe ç'është e vërteta, punët nuk i shkojnë keq! E ndihmon shumë fakti që zgjedhjet nuk bëhen të gjitha njëherësh. Kështu p.sh., sa të vijnë zgjedhjet e organizatës së rinisë (ku drejtori mban postin e anëtarit të byrosë), ai ka bërë mbledhjen dhe ka shtruar detyrat e para në organizatën e Frontit (ku udhëheq si kryetar prej disa vjetësh), ose ka mbledhur këshillin e kulturës dhe u ka bërë instruktimet përkatëse... (si kryetar që është). Mirëpo nganjëherë ndodhin edhe ngatërresa. Kështu p.sh., një herë, ndërsa ishte duke përfunduar mbledhjen e organizatës së rinisë, një mësues vjen dhe e njofton:

— Shoku drejtor, ne u mblodhëm të gjithë, po ju presim!

Po ku e presin, drejtorit nuk i kujtohet fare. Ç'të mbajë mend më parë. Ose, drejtori është duke zhvilluar formën politike me mësuesit, kur një shoqe futet në derë dhe e njofton:

— Drejtor, ne po ju presim ju!


Drejtori shtang në vend, i shkreti. Nuk i kujtohet për ç'mbledhje është fjala dhe e zë frika se mos është i papërgatitur për ndonjë temë që mund t'i kenë ngarkuar ato të organizatës së gruas.

Pas pak i kujtohet gjithçka. Shoqja e njofton drejtorin për mbledhjen e një komisioni që do të verifikojë pemët e fshatit. Kuptohet që një komision i tillë s'mund të drejtohej nga një njeri dosido! Duheshin numëruar rrënjë për rrënjë qindra pemë e mbi të gjitha kjo punë kërkohej shpejt! Epo, sipas Zenelit, ku mund të gjesh njeri që di të numërojë më shpejt e më sakt se drejtori i shkollës?!

Ndodh që në mëngjes, kur niset për në shkollë drejtori, këmbët e çojnë në qendrën e kooperativës, ose në mbrëmje, kur niset për në shtëpi, përfundon në zyrat e këshillit popullor, ku e presin dy fshatarë, të cilët do t'i japin hesap pse kanë prerë dru në pyll pa leje... I duhet të bëhet një mijë copa!

Kohët e fundit zgjohet natën dhe përgjon... Ja, i bëhet se dikush e thërret. Shpejt hap dritën, dhe duke i fërkuar, ia ngul sytë grafikut të mbledhjeve që mban te koka. Mbledhje s'ka. Atëherë qetësohet, tund kokën me nervozizëm dhe, pasi fik dritën, shtrihet. Po zëri, si për inat, përsëritet më i fortë. Atëherë hidhet rrëmbimthi nga krevati, gjysmëlakuriq e me mendjen te ndonjë i deleguar dhe hap derën.

Por, jo!...




Në mëngjes i kujtohet si në ëndërr, se me dikë ka folur në gjumë, me dikë është sharë... Po me kë vallë? Me ata të seksionit të arsimit apo me Zenelin me shokë, që e katandisën burrë tridhjetë kile?

PATAT ME BISHT DHE PATAT PA BISHT

Sopa u bë brigadier, Bidoja i shtoi pulat e rosat, pulat e detit, bile edhe dy derra i rriti sa një viç dhe i shiti në pazar. Po gjithë e gjithë kufirin e kaloi me ato patat! Dhe pse të mos e kalonte? Shtëpinë e kishte në mes të bllokut të kooperativës me misër e me grurë përreth.

Lamja, roja e kooperativës, dilte me dy-tre hostenë diell në fushë. Në krah mbante shufrën me një verigë në majë. U afrohej patave dhe u hidhte lakun në qafë. Patat gaaa, po Lamja donte të shihte a kishin nishan në këmbë. Se patat e brigadierit kishin nishan që të dalloheshin nga të tjerat. Sapo u shihte nishanin, Lamja i lëshonte sikur t'i digjnin duart dhe kthente krahët. Po taksirati ama binçe mbi mua. Se, ti e di! Shtëpia ime, as një gur hobeje s'është larg asaj së Bidos. Sa herë çmohej drithi i dëmtuar, urdhërohej t'u bëhej ngarkim familjeve përçark. Brigadierit, edhe në ia ngarkonin, bënte si bënte dhe e shkarkonte përsëri, po halli im!? Dhashë e mora, s'kishte rrugë tjetër! Nuk mund të paguaja unë për patat e Bidos gjithë jetën.

— Sëpatën! — i thashë gruas një mbrëmje dhe



u sula nga koteci. Mirëpo, edhe gruaja kishte kohë që mendonte të njëjtën gjë, dhe çoç i kishte pjellë mendja. Ma rrëmbeu sëpatën dhe më tregoi duart tërë pikla gjaku.

— I there? — u gëzova unë.

— Jo, — ma priti ajo duke më shkelur syrin. — Vetëm sa i shënova në këmbë! — Dhe, pasi m'i afroi buzët te veshi, pëshpëriti:

— U kam bërë nga një nishan si ai që kanë patat e Bidos, brigadierit!

— Hallall, grua! — i thashë tërë qejf. — Të lumtë, për nder. . . Flori e ke atë mendje! . . Po dëgjo! Mos llap gjëkund se të dëgjon Lamja dhe. . .

Pas ca ditësh morëm vesh se Lamja i kishte vënë në përpara edhe patat e mia dhe i kishte shpënë në shtëpinë e brigadierit. Por e shoqja e Bidos i njohu menjëherë të kujt ishin dhe marifeti i gruas sime kaq e pati!

Që të dalloheshin më mirë e të mos ngatërroheshin me të tjerat, patave të brigadierit u ranë me sëpatë në... bisht dhe ua prenë pendët. Kështu dukeshin si dhelpra me bisht të prerë që tregohet në përrallë, por ama Lamja i njihte që larg dhe nuk i prekte, edhe sikur ta hanin grurin e kooperativës. Epo janë patat e brigadierit, nuk i thonë shaka!

Mirëpo edhe kjo nuk zgjati shumë, pasi fshati po fliste për ca pata pa bisht që dëmtonin arat e kooperativës. Edhe vetë Lamja e kuptoi që patat e kishin nishanin shumë të dukshëm... Pastaj edhe ata të rinisë se si e qysh e gjetën llafin dhe vunë një fletërrufe, ku thoshin fare hapur se për grurin e ngrënë nga patat pa bisht do të përgjigjeshin brigadier Bidoja e rojtar Lamja. U duk sikur Bidoja u prek aq shu-


më, saqë një ditë të diel i shiti patat në pazar. Kjo bëri bujë të madhe. Bile disa thanë se brigadieri pas-kësh qenë njeri me shumë sedër dhe e rënduan duke i rënë në qafë me fletrrufe.

Mirëpo mençuria e Bidos dhe e rojtar Lames për këto punë, shkonte më tej nga sa pandehnin disa bashkëfshatarë. Ai bëri si bëri dhe solli në shtëpi nga pazari po aq pata, sa kishte një ditë më parë. Patat e reja ishin ndryshe nga tonat: të gjitha të bardha, qumësht. Kuptohet, që për Lamën kjo kishte rëndësi të madhe. Njëqind metra larg ai i dallonte ato nga patat e mia të murme e larashe. Përsëri filloi avazi. Patat e mia kullosnin në rrugë dhe flinin të mbyllura nga Lamja në stallat e sektorit të kooperativës. Patat e brigadierit hanin grurë gjithë ditën dhe flinin qetë-qetë e rehat në kotecin e tyre. Kësaj së keqeje i shtohet edhe gjoba që paguaja e telendia që merrja nga fshati. Një mendje më thoshte të raportoja atje ku duhej; po kur ia thashë këtë gruas, ajo më mbyti:

— Sikur s'e di ç'hakmarrës është Bidua! Apo ke qejf të të qepet si ferrë?

U pa puna! Këtë radhë u bëra unë burrë. Një të diel patat i çova në pazar dhe sytë katër për të gjetur të bardha, si të Bidos. U lodha ca por i gjeta më në fund dhe i bleva. Pas dy netësh, patat tona ndërruan vendet: të brigadierit i çuan në stalla dhe të miat në kotecin e tyre. Të nesërmen u mor vesh e vërteta.

Kjo e pezmatoi aq shumë rojtar Lamën, sa u betua se do të hakmerrej. Dhe ç'është e vërteta mua më zuri frika, pasi betimi ishte bërë në praninë e brigadier Bidos, i cili, me sa më thanë, e kishte dëgjuar me një buzëqeshje plot domethënie...



Bidoja shkoi prapë në pazar, shiti patat e bardha dhe i bleu laramanë. Mbase nuk është mirë ta thash, po kjo punë u mor edhe një çikë inatshe. Kur pa gruaja ime se Bidoja prapë i kishte ndërruar patat, bëri edhe ajo të njëjtën gjë. Kështu vazhdoi derisa Lamja i ra në erë edhe kësaj hileje dhe priste patat e mia të dilnin nga porta se... duhej paguar gruri që hanin ato të Bidos. Pastaj, ç'rojë do t'i thoshin atij, po të mos çonte gjë të gjallë çdo ditë në stallat e sektorit?

— Po mirë, mos ishte edhe sot në pazar për të ndërruar patat Bidua? — pyeti dikush.

— Jo, jo! — u përgjigj një tjetër entuziast. — Jo, sepse pardje u bë një mbledhje për brigadierin dhe e hoqën. Kështu, në vend që të ndërronim patat, ndërruam brigadierin dhe Lamën!

MËSUESI DHE THESI ME SPECIA

Sa herë vinte llafi për djalin e vogël të xha Gorit, një pjesë përdridhnin buzët: «I mirë, o, i uruari, po ç'e do, s'e lë sqima!... I zgjuar sa të thuash, por ja, hunda përpjetë, ama!»

Disa mendonin se, kur të kthehej nga shkolla, do të ndërronte tabiat, se, helbete, shkolla të hap sytë, të bën njeri me kulturë e me edukatë. Dhe Mitrin shkolla e nxori mësues! Por vetëm mësues, ama!... Moshatarët u gëzuan që u erdhi mes tyre, por Dhimitri tani ishte mësues e jo shaka!

Ai filloi ta tregonte veten se ishte njeriu që mbyllte në kokën e tij të vogël, me flokët gjithë shkëlqim e të krehur me gusto, një barrë me mend, të mbledhura për vite me radhë.

Tani ishte zor të futeshe në muhabet me Mitrin e dikurshëm. Pale ta quaje shok e t'i kujtoje fëmijërinë! Po t'i kujtoja për shembull se si kishim ndjekur qentë me të nëpër mëhallë, si na përgëzonte nëna kur sillnim dru të thata nga pylli e na gostiste me nga një copë bukë misri të ngrohtë të porsanxjerrë nga çerepi me një çikë gjalpë përsipër, ai do të tërbohej fare. Si iku ajo kohë!

E shikojmë Mitrin kur vështron që prapa gjyz-lykëve larg në horizont, dhe pyesim njëri-tjetrin:

— Vërtet ky të jetë Mitri ynë?!

Njëherë, kur Mitri ishte akoma në institut si student, i dërgoi një letër të atit, xha Gorit, i cili njihej si njëri nga barinjtë më të dalluar të kooperativës. Në zarf kishte shkruar: «Merr Ligor Rrëza». Postieri vrau mendjen e pyeti po nuk dinte që fshati të kishte emër Ligor... Kur panë atë që e dërgonte, e kuptuan se letra ishte për xha Gorin. Mitri, si student që ishte, s'mund t'i thoshte Gori, siç i fliste gjithë fshati dhe e pagëzoi me emrin Ligor të atin...

E shtrëngoi xha Gori letrën në gji për t'u çmallur, sikur të përqafoste të birin dhe u nis për në shtëpi që t'ia lexonte e bija. Duke ecur vetëm, ashtu buzë mbrëmjes, bluante në mendje ato që i tha Vangjeli, brigadieri i blegtorisë:

«Miçua na qenka bërë kumbar, o xha Gori! Në vend që të mësojë për të na i shkruar mirë emrat që kemi, na vë emra të rinj!...»

— Jo, belaja, de! — mërmëriste nëpër dhëmbë xha Gori. — Edhe kjo na duhej! Oj Ligor!... Po ama xha Gorin e njohin të gjithë, mor bir! Po pse, tani në pleqëri do ta zbukuroj unë këtë të uruar emër? Se mos po më prish punë emri mua!... Po ai vetë? Dhimitër! Eëë? Eh, Mitri i babës! Do të bëhet kumbar thotë Vangjeli! Jo, or, jo kumbar, por mësues do të bëhet!...

Këto gjëra po i kujtoheshin xha Gorit edhe këtë mbrëmje vjeshte, duke dëgjuar e parë të birin, që po i çirrej së shoqes me inat:

— Për specat e tu u bëra copë e çikë! Jam ngjeshur me baltë si buallicë!

Pastaj ra heshtja, të cilën e theu xha Gori:

— Po pse, more bir, vijnë plot qerre e makina nga ajo rrugë. Ia jepje ndonjërit prej tyre. Ose, së paku, niseshe më herët e vije me ditë. Do kishe ardhur i thatë e i palerosur!

Mitri bëri sikur nuk dëgjoi asnjë fjalë nga ato që i tha i ati. Po deri në fund nuk iu durua. Shikoi njëherë vëngër e shpërtheu:

— E kur shpejt të nisesha, që në drekë?!

— Po jo që në drekë, more bir, po me diell të paktën!

— Me diell, posi! Dhe ato punët atje bëhen vetë!

— Epo, aq kohë e gjeje, sa të sillje edhe ti një thes me speca, si gjithë bota, de! — iu kthye e shoqja. Dhe, si për t'i dhënë fund muhabetit, u drejtua nga thesi me speca, i cili ishte shqyer ngaqë Mitri e kishte përplasur me forcë në oborr. Thesin e kishte mbushur dëng, duke e ngjeshur, që t'i mbyllej goja së shpejti e të mos kërkonte më. E ëma, që po mblidhte specat e shpërndarë andej-këndeje nëpër oborr, ndërhyri:

— E, mjaft de, mjaft, se lahesh prapë!... Ja, hiqi rrobat e ndërrohu tani!

— Oho, për të larë e ndërruar kollaj, — tha xha Gori, — po shko nesër e shihu te doktori, thuaji se i ke bërë gjak bërrylat e gjunjët!

Mitrit po i buçisnin veshët e koka. Shkoi në dhomë, u la, u ndërrua e, pasi u shtri, filloi të kujtonte tërë ngjarjen. Gjithë fajin ia hidhte së shoqes, që i kishte ngrënë veshët kaq ditë me radhë për specat:

«Jo janë të mirë, jo po na duhen turshi për dimër...» E ç'nuk i thoshte çdo mëngjes kur nisej për në shkollën e fshatit fqinj, ku punonte si mësues.

Edhe atij vetë i pëlqenin shumë ata djall specat. Eh, si u shtrohej Mitri atyre në dimër, pas zjarrit, me fasule e bukë të thekur!... Mirëpo si mund të ngar-

kohej edhe ai, si gjithë të tjerët, me thes në krah? Jo xhanëm, kjo punë s'bëhej! Ishte apo s'ishte mësues Dhimitër Rrëza!? Dhe mos pandehni ju se ishte ndonjë mësues dosido! F'shatai kishte tetëmbëdhjetë mësues, po Dhimitri kishte shok veten ama!

Fjalët e së shoqes iu bënë refren mëngjes për mëngjes, saqë u detyrua të bënte diçka. Porositi dy nxënës të klasës së tetë dhe u dha lekët e thesin të mbledhur pako me gazetë.

Gjithë pasditen qëndroi duke lozur shah në shtëpinë e kulturës dhe priti sa ra errësira e plotë. Pastaj shkoi në depo, ku kishin lënë nxënësit thesin, e vërviti mbi kurriz dhe doli nga dera e pasme e shkollës, sikur të ishte ndonjë hajdut.

Kur i vinte dikush përballë, ulte kokën nën peshën e thesit dhe nuk i përgjigjej përshëndetjes së tjetrit, nga frika se mos e njihnin nga zëri. Që t'i shmangej rrugës kryesore, u ra përmes blloqeve të mbjella mbi mezhdat e kanaleve vaditëse. Po përpara i doli një kanal me ujë. Iu afrua dhe, nën dritën e mjegullt të hënës, dalloi dy gurët, që i kishin vënë për të vendosur këmbët mbi ta. Duke u munduar që të ruante ekuilibrin, nën peshën e thesit me specat, e zgjati këmbën në drejtim të gurit dhe mori hov. Mirëpo... guri u kthye përmbys dhe gjysma e thesit ra jashtë kanalit. Mitri vetë ra i tëri brenda.

U ngrit rrëmbimthi dhe e pushtoi tmerri kur e kuptoi se kishte klithur fort «uh, uh!». Po sikur ta kishte dëgjuar njeri?!

Në këto e sipër, as vetë s'e mori vesh se nga i erdhi një zë:

— Po pse nxitohesh, more djalë?! — dhe sytë e çakërritur të Mitrit njohën rojën e kooperativës që u kërrus e i vuri duart thesit për ta ndihmuar. Po Mitri



s'e dha veten. Hodhi mbi sup thesin që kullonte ujë dhe nxitoi pa thënë asnjë fjalë. Nga pas dëgjoji të qeshurën e rojës... Tëmthat nisën t'i rrihnin fort. Këmbët i hidhte si i dehur.

Ç'do të thoshin nesër në fshat e në shkollë?! Ja, kjo pyetje e brente thellë vetes e nuk e linte të qetë. «Profesor Dhimitër Rrëza u la në kanal bashkë me turshitë!... Dhe kush pa?!... Ah, grua, grua, ç'më bë-

re! U helmofsh me gjithë specat! Të lumtë ty, kur të dëgjova unë! pse mos ta pësoj?!!!

Këto po sillte ndër mend ashtu, i shtrirë më kurri në krevat, me sytë të pantallonat e varura, që e kishin humbur ngjyrën e nderur nga lluca e kanalit.

«Shyqyr që ishte natë! — ngushëlloi veten.

— Ah, sikur të mos më kishte parë njeri! Po ai roja plak ku u gjend tamam aty?! Rri e dëgjo këngën tani nëpër fshat!»...

Deshi të lëvizte po ndjeu dhembje në ije, në bërryla e në gjunjë. Në dhomë hyri xha Gori me një kaush duhan në dorë.

— Të t'i bëjë babai me një çikë duhan ato vendet e vrara, se mos të enjten!

— Nuk i shëron duhani ato, jo! — tha prerazi Dhimitri.

— Hë, bir! Dhe herë të tjera nisu me ditë... Pse të dalësh natën për specat? Edhe sikur specat djegës të jenë, merri ditën, se natën e pëson, të keqen Ligori...

— Cili Ligor?

— Yt atë pra, që i ndërrove emrin kur ishte student. Nuk të kujtohet?

Mitri mbuloi kokën me jorgan dhe nuk u ndie më. Fjalët e të atit e dogjën më keq se specat djegës...

DOLLIA E FUNDIT

Karvani i të ftuarve që shkonte drejt shtëpisë së Daut beut po shtohet. Dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe, kur prapa gostisë për shtëpinë e ré që kishite ngritur zoti Daut, ishte përgatitur një mbledhje me rëndësi nga baballarët e kombit në atë zonë.

I pari dha ballë Selmani, me nja katër a pesë tri-ma, të gjithë të ngarkuar sa mezi hiqnin këmbët. Seloja printe i ndjekur nga ca bletë, të cilat uleshin e ngriheshin në dy enët e bakërta plot me mjaltë të freskët.

— Të rrini gëzuar e me fitore, zonjë! — e uroi ai të shoqen e Dautit. Lëshoi enët, ndreqi pisqollën dhe u bëri shenjë shokëve. Edhe ata e lëshuan ngar-kesën, u mbushën me frymë dhe filluan të fshinin djersët. Seloja iu afrua përsëri zonjës dhe e pyeti:

— Ka urdhëruar ndonjëri nga zotërinjtë, apo?...

— Jo, akoma! — tha tërë mendjemadhësi e fodu-llëk e zonja e shtëpisë. — Po shpejt është!

— E, jo, nuk thashë xhanëm! Për shpejt, shpejt është akoma... — u përtyp Seloja, pa e çuar mendi-min deri në fund.

Ndoni pa edhe të tjerë që iu drejtuan portës së Dautit, të gjithë të ngarkuar me pulastrenë, rosa e

pata, qypa e trasta. I shkuan sytë edhe në cepin tjetër të oborrit pas kasolles, ku rrinin lidhur dy dema e një mëzat. Poshtë degëve të fikut vareshin lëkurët e dy deshve, që kishin pasur nderin të bëheshin kurbanë për shtëpinë e ré të zotit Daut...

«Të gjitha këto duhet të jenë plaçkë e luftës që ka zhvilluar Dauti bashkë me ballistët, vetëm gjatë natës së fundit», mendoi Ndoni duke buzëqeshur.

Si hyzmeqar në atë shtëpi, ai kishte disa vite, por, veçanërisht që kur filloi punën për ndërtimin e kësaj shtëpie të ré, njohu më mirë të zotët e saj dhe trimëritë e tyre.

Fshati e dinte se Ndoni Gjika nuk përzihej në punët e luftës, as në njërin dhe as në tjetrin krah. Bile ndonjë e shikonte edhe një çikë si vëngër, si hyzmeqar bësNIK të Daut beut. Po shumica e njihte ashtu siç ishte, një fshatar i këputur, po i ndershëm e, mbi të gjitha, një usta i mbaruar për konak e çati.

Kur shkoi në derën e madhe të Daut beut, në fillim ruajti dhinë, dhe më vonë mundi ta bindte të zotin se vlente më shumë si usta. Atëherë Daut beu piqte mendimin për një shtëpi të ré e të bukur, si kjo që bëri, shtëpi që të kishte shoqe veten në tërë Myzeqenë. Dhe ashtu vendosi. Por para se të fillonte nga puna për shtëpinë e ré, e çoi Ndonin për t'u bërë shtëpinë disa miqve, duke iu mburrur se ishte nga ato dyer, që mbante për hyzmeqar jo vetëm çoban dhish e lopësh por edhe ustallarë të zotë, si Ndonin. Ndoni e kuptonte se për të kjo ishte një farë prove, përpara se të fillonte shtëpinë e të zotit. Dhe hyzmeqari usta e bindi të zotin për mjeshtërinë e tij. Atëherë u thirr gjithë fshati argat dhe, nën drejtimin e usta Ndonit, filloi puna për ndërtimin e shtëpisë së ré.

Puna vazhdonë sahat dhe shtëpia po merrte pa-

mjen përfundimtare. Vetëm për një gjë i mbeti merak zotit Daut. Për t'u dalluar që larg nga të tjerat, ia kishte qejfi t'i qëndiste shtëpisë një oxhak. Asnjëri nga ustallarët që njihte rreth e rrotull nuk e merrte përsipër ta bënte. Dhe kollaj s'ishte, përderisa nuk kishin bërë ndonjëherë oxhakë të tillë. Pastaj prova nuk bënin dot me shtëpinë e zotit Daut!

Një natë erdhi në shtëpinë e Ndonit Peçoja, djali i Kozit bashkë me një shokun e tij, të dy partizanë. Megjithëse erdhën vonë, biseduan deri në të gdhirë. Të nesërmen ata ikën dhe Ndoni hodhi trastën e ustallëkut në sup, pasi kishte futur në të mistri e sqepar. Pas pak u gjend në oborrin e zotit Daut me një mendim të ri... Pasi i tregoi ç'mendonte dhe i foli për dëshirën që kishte për ta parë shtëpinë e të zotit me oxhak të bardhë e të bukur, iu zotua se do ta bënte vetë dhe do ta bënte mirë.

Që atëherë kishin kaluar shumë ditë. Oxhaku kishte hedhur shtat dhe e kishte nxjerrë kokën mbi çati.

Por pikërisht sot, kur shtëpia e Dautit priste miqtë e zemrës e të pushkës, oxhaku ishte ende i pambyllur dhe Ndoni s'po dukej. Tre vetë kishte dërguar Dauti në shtëpinë e ustait, e të tre ishin kthyer bosh.

— Qeni i qenit!... Ky maskara, ta sjellë deri në këtë gjendje e ta lërë oxhakun shyt, pa mbyllur?!... Bukuria e shtëpisë oxhaku është! Më turpëroi para zotërinjve! — shante Dauti me mendjen tym nga andrallat e asaj dite.

Që kur e pa shtëpinë në të mbaruar, Daut beu e kishte vendosur që ta shfrytëzonte gostinë, për t'u njohur më mirë me miqtë e bashkëluftëtarët e tij.

Shtëpia e re, mendonte ai, do t'i sillte miq të rinj, e, pse jo, edhe detyra e grada të reja më të larta. Ta-

ni që shtëpia mbaroi, e pleqëroi shtruar këtë dëshirë me Sulo beun, i cili, në zinxhirin e gjatë të miqësisë së zotit Daut, zinte qoshen e odës.

Katër ditë para kësaj gostie, Ndoni i kërkoi leje për të shkuar te një miku i tij, andej nga fshatrat e Mifolit. Atje do të shihte një oxhak, pasi vetë nuk ishte i sigurt vetëm për kryet e oxhakut.

Ustai mezi e bindi të zotin dhe e siguroi se do të kthehej shumë shpejt. Kështu u zhduk për tri ditë rresht.

Në atë gjendje që ishin katandisur ballistët e asaj zone nga goditjet dhe ndikimi i partizanëve, u duhej një mbledhje për udhëzime rreth një organizimi të ri për t'i ngritur moralisht. Kjo ishte kërkesa e miqve të rinj gjermanë, që ishin munduar gjer në ato anë.

Një mbledhje e tillë në ato kushte, të kushtonte kokën. Prandaj Sulo beu propozoi të bënin një rrugë e dy punë; të përdornin si sebeb gostinë e shtëpisë së ré të mikut të tij besnik, Daut beut.

Kur Dauti po dalldisej në këto mendime, u dha te porta Ndoni me trastën e ustallëkut në krah. Sa e pa Dauti, instinktivisht i shkoi dora në brez, te koburja (kështu i ndodhte sa herë që nxehej shumë).

— Po ku e humbe bojën kështu, more... i paudhë, more, more?! ĒĒĒ. Ç'domethënë kjo? — Dhe duke i rënë gjoksit me grusht, shpërtheu: — Kjo kockë të ka ushqyer një jetë të tërë me bukë dhe sot të më nxish faqen?!... Haram e jazëk! Hajde, mbushu tani, se s'ta kam nevojën!

Ndoni pa bishtin e mustaqes së Dautit që i dri-dhej dhe e kuptoi se i zoti ishte nxehur jashtë mase. Megjithatë qëndroi përballë pa i folur. Hapi trastën, nxori që andej një top metalik në formën e konit, me

një spango në bisht, sa për t'u gjendur me diçka në duar dhe iu drejtua të zotit:

— Ustallëku kërkon aletet e veta, o bej!... Pastaj, po s'pamë njëri-tjetrin, kjo e shkretë mendje s'na pjell de! Po unë të kam thënë: oxhaku është gati i mbaruar. Me dy-tri orë punë çdo gjë merr fund.

Zotrote shiko hallet e tjera, të nderosh miqtë, pa këtej do ta nderoj unë zotërinë tuaj dhe veten! Kam qejf që dollinë e kësaj shtëpie ta ngre atje, majë çatisë, duke i dhënë dorën e fundit oxhakut.

Po Dauti s'deshi të dëgjonte më tej. Ktheu kurri-
zin dhe iku duke turfulluar e sharë nëpër dhëmbë. Ndoni e dinte se, ajo që mund të bënte sot me oxhakun, s'kishte asnjë rëndësi për beun e tij, pasi miqësia po mblidhej dy-tri dhoma më tej nga ajo me oxhak. Po diçka pa tjetër duhej bërë. Pak si fshehur e në heshtje, Ndoni bëri të tijën. Vuri shkallët dhe iu ngjiti strehës së pasme. Filloi peshimet me shaull, duke bërë zhurmë, për të krijuar përshtypjen se po bëhej copë që të nderonte të zotin e shtëpisë.

Gjithçka shihte poshtë, Ndonit i kujtonte panairret që bëheshin në manastirin e Ardenicës, ku vinin e thereshin kurbanët varda, që besnikët ta ndienin veten të qetë e të ngopur.

Aty nga ora dhjetë u dukën mysafirët më të nderuar. I kryesonte vetë Sulo beu. I pritën me të gjitha nderimet që u kërkonte emri e arma dhe i futën në dhomën e miqve, shtruar me qilima një pëllëmbë të trashë. Pa u uruar akoma mirëseardhjen atyre, mbërriti te porta grupi tjetër. Me ta ishte në mes një kuqalosh i shkurtër, veshur civil, të cilit të gjithë mundoheshin t'i shpjegonin, me fjalë e me duar, mendimet e tyre.

«Gjermani!...» mendoi Ndoni, i gëzuar se po vër-

tetoheshin të dhënat e shokëve. «Gjynah që s'ka marrë edhe ca nga shokët e tij!, — mërmëriti. — Po ne jse! Kanë edhe ata radhën e tyre. Këtu me siguri kanë dërguar më të majmin!»... — dhe ia nguli sytë gjermanit kuqalosh.

Miqtë nuk po vinin nga rruga kryesore, po nga një monopati. Për të ardhur këtu, nuk i ranë përmes fshatit, por anash dhe ecnin shpejt. Dukeshin që trembeshin e i ruheshin syrit të njerëzve. Kjo kuptohej edhe nga masat që kishin marrë. Përpara çdo grupi ecnin dy-tre ballistë të armatosur. Në shumë rrugë, shtigje e vende të fshehta, ishin caktuar njerëz që vëzhgonin. Për të gjitha këto kujdesej vetë Sulo beu, që ishte strumbullari rreth të cilit vërtitej e mbledhej ky mexhilis.

Që atje ku vëzhgonte, Ndoni arriti t'i numëronte të gjithë mysafirët që hynë në shtëpi, duke bërë nga një shenjë në suvanë e oxhakut.

Pa u ndezur mirë ahengu, Sulo beu doli vetë përjashta, diçka foli me zotin Daut dhe, pas pak, dy ballistë të armatosur dolën duke sharë nëpër dhembë e zunë vend në dy cepat e fundit të oborrit për të përforcuar rojat.

«Të madhe e paskan frikën qerratenjtë», mendoj Ndoni. Numëroi edhe një herë shenjat në suva dhe i dolën plot tridhjetë e dy.

— Shenjë e keqe, — tha me vete. — Do të digjen të tërë?! Pastaj lëvizi tezgën me llaç dhe zbuloi grykën e automatikut që kishte fshehur në një thes të vjetër. Kishte edhe dy bomba...

Ndoni, në heshtje po dëgjonte dollitë që rrokulliseshin me fund nga baballarët e kombit:

— Hajde gëzuar...! Gëzuar, Daut bej! Gëzuar, zoti Sulo! Zoti Reshit, gëzuar! Gëzuar të gjithë, zotërinj e me fitore! Me fund, zoti Reshit... Me fund, të lutem; është për fitoren!

— Mos i bjer më qafë zotit Reshit, ai do të mbarjë raportin! — i pëshpëriti dikush dollibashit, që ishte bërë çakërrqejf.

— Si të urdhëroni, zoti Reshit... si të doni, domethënë!

Ndërkohë Reshiti po mbushte tjetrën. Ndërsa dollia vazhdonte litar, Ndoni nxori nga xhepi një shami të kuqe dhe e vendosi në krye të oxhakut si flamur. Një kilometër më tej, në majën e vidhit të Bunacit, Ndoni pa që u tund një shami tjetër e kuqe. I gëzuar për atë që pa, zbriti shkallët dy e nga dy. Tani edhe pak minuta kishin mbetur. Brezi i parë i sulmit partizan po ngushtonte unazën anës kanalit që rrethonte oborrin. Të tjerët zvarriteshin matanë kanalit, në drejtim të shtigjeve që të sillnin te shtëpia e Dautit.

Brenda dallohej herë zëri i Reshitit, herë ai i Sulos, që thërriste si me të qarë:

— Do ta djegim, Dauut! More vesh, o Daut bej!... Do ta djegim, thashë!...

— Hallall, zoti Sulo, hallall të gjitha! — përgjigjej tërë gaz i zoti i shtëpisë.

S'merrej vesh as kush fliste as çfarë thoshte. Ishte një rrëmujë, saqë nuk e merrte vesh i pari të fundin. Në këtë gjurulldi, edhe krismat e para të automatikut të Ndonit, që palosën rojat, Dauti i quajti **zhurmë të ustait mbi çati; prandaj, i nxehur sa s'behet më, doli që ta përzinte. Por, sa hapi derën, u palos përmbys. Një partizane e kishte vënë në shenjë...**

Sikur të kishin zbritur nga strehët, sa hap e mbylli

sytë, partizanët vërshuan në oborr. Të tjerë kishin zënë pozicione në hendekun pas shtëpisë dhe në shtigjet kryesore të fshatit. Pas breshërisë së parë që lëshoi Ndoni dhe dy bombave që shpërthyen jashtë, rrëzë dritareve, ata brenda akoma s'po e merrnin veten.


— More Daut! Dauut!... Ku u fute, o kopuk?!
— thërriste njëri me zë të përvajshëm. Po Dauti e kishte kthyer dollinë me fund.

— Tradhti, tradh... Tradhtar, — çirrej dikush tjetër. — Do ta vras me dorën time!

— Cilin do të vrasësh, të vdekurin?

Kur panë Dautin shakull përdhe, u doli rakia të gjithëve. Murmuritjet tani u ngjanin më shumë angjullimave. Fjalët e thirrjet që pasoheshin nga rrahjet e gjoksit, reshtën në sekondë nga një zë që gjëmoi njëherësh në derë e në dy dritaret:

— Duar lart! Asnjë lëvizje!



Disave u ngriu dora në brez. Të tjerë shtrëngonin akoma gotën e shanin dollibashin për prishjen e rregullit... Por më i çakërdisuri e më i hutuari nga të gjithë dukej Sulo beu. Me fytyrën e tromaksur nga frika e inati, bëri dy hapa pas dhe qëndroi si i ngrirë... ia nguli sytë në bebe partizanit që foli dhe diçka deshi të thoshte, po nuk arriti...

— Duart lart! — gjëmoi sërish po ai zë. Në derë u futën xha Llazi me Ndonin.

— Oh, oh, më të lumtë, more Ndoni! — Iu ngopën syri e zemra xha Llazit kur pa gjithë ata zotërinj me duar përpjetë, ndërsa ndonjëri, ngaqë i qe prishur mendja, shtrëngonte edhe gotën. — Nga një palë opinga për shok na ke kursyer, o Ndoni, se... kushedi sa do bridhnim për t'i zënë një nga një tërë këta dollibashë!...

QAJ, SE TË VRAVA!

Agimi i asaj dite vjeshte të dyzetekatrës Kozit i dukej se po vononte. Ai kishte fjetur vetëm dy-tri orë, edhe ato me mendje të ngritur, e para mesit të natës zuri bregun e kënetës.

I mbledhur me gunën e dhirtë e të vjetër, kaloi orë të ftohta në ankthin e pritjes. Ishte vjeshtë e vonë dhe mëngjesi i ditës që po vinte dukej si i shpëlarë. Mbi kokë i vareshin ré të dendura, që nxitonin drejt perëndimit duke shtyrë njëra-tjetrën.

Kozi, i ulur këmbëkryq rrëzë një zhuqe, herë pas here largonte me dorë gjethet e plepishteve që e gudulisnin në qafë e në fytyrë. Përreth ndiheshin lëvizje e zëra shpendësh e insektesh, po Kozi asgjë nuk dëgjonte. Në mendje kishte akoma fjalët e zëvendëskomisarit të batalionit, Spiros.

— Dëgjo Kozi! — i kishte thënë ai. — Pasi e pleqëruam edhe me shtabin e batalionit, vendosëm të të ngarkojmë me një detyrë. Po është detyrë partizanësh ama dhe duhet ta kryesh si partizan. Je vërtet ca i moshuar, po ne besojmë se do ta kryesh me sukses!

— Hë, hë, qerrata djalë!, — pat murmuritur atë-

herë me vete Kozi. — Po pse, ore Spiro, detyrat e tjera që më keni ngarkuar nuk i paskam kryer si partizan? — Këto gjëra po tirte në mëndje edhe tani, i ulur buzë kënetës, nën kaçubë dhe lëmonte me dorë koburen. Hekuri i armës dhe vesa e mëngjesit ishin të ftohta, po Kozi nuk i ndiente fare.

Disa metra më tej shtrihej bregu i kënetës. Uji llapashitej nga një fllad i lehtë dhe Kozi dëgjonte përplasjen e tij në drurin e regjur të lundrës, që, sa herë tërhiqej për t'u larguar nga bregu, i tringëllinte zinxhiri me të cilin e kishte lidhur pas një plepi. Këneta e paanë, që shtrihej përballë dhe pylli me zhukë e plepishte që kishte pas shpinë, kishin qenë jeta e tij qysh në vogëli. Ktheu kokën nga lindja dhe dalloi vargun e kodrave të Ardenicës, harku i të cilave shtrihej deri tutje në drejtim të Divjakës. Konturet e kodrave mezi dalloheshin. «Sa shpejt qenkam ngritur», mendoi Kozi dhe tërhoqi cepat e gunës. Nga mendimet e shkëputi guak-guak-u i një zhabe, që përpëlitej më kot për të shpëtuar nga dhëmbët e një gjarpri.

— Hej! — tha nëpër dhëmbë dhe dora prapë i lëmoi grykën e kobures. — Edhe gjarpri në gjumin e sabahut i gjuan zhabat... Kot s'i thonë gjarpër! — dhe largoi një gjethe për të shikuar më mirë. Nga lindja filluan të qartësoheshin konturet e kodrave. — Po fillon të zbardhë dita! — pëshpëriti me vete dhe ndjeu t'ia përshkonte trupin një e rreqethur. Përsëri iu kujtuan fjalët e zëvendëskomisarit. Buzëqeshi duke tundur kokën dhe u ngrit. Eci ngadalë deri te lundra dhe e treti shikimin mbi të, sikur të donte ta pyeste nëse ishte në gatishmëri... Pastaj e tundi barkën dy-tri herë dhe mendja i vajti te gjermanët e te ballistët, për të cilët i kishte folur Spiroja.

Sulmi mbi ta ishte parashikuar të bëhej në mën-

gjes herët. Një pjesë e batalionit partizan kishte ardhur në fshat një natë më parë dhe strehohej nëpër familjet e fshatarëve. Ishte menduar që pas aksionit, i cili do të kryhej në mënyrë të rrufeshme e të befasishme, partizanët do të tërhiqeshin drejt bregut të kënetës, ku i priste Kozi për t'i nxjerrë me barkë në bregun tjetër, jashtë rrezikut. Kozi ecte i menduar rreth vendit ku ishte lundra. Drita po shtrihej mbi sipërfaqen e qetë të kënetës. Në këto çaste u dëgjuan krisma në thellësi të fshatit.

Kozi u kthye rrëmbimthi andej nga krisën pushkët, e nguli vështrimin diku larg dhe një zjarr i brendshëm ia përshkoi trupin. Fytyra iu gjallërua, në sy e në buzë iu shtri buzëqeshja.


Qëndronte në këmbë si i ngrirë, po mendjen dhe zemrën i kishte larg. Herë-herë pushkët pushonin. Pastaj ndonjë shpërthim granate a breshëri automatiku dhe krismat vazhdonin një copë herë pareshtur. I bëhej sikur dëgjonte thirrje të fuqishme... Më në fund krismat pushuan. Pasi ndenji edhe një hop ash-tu në këmbë, Kozi iu afrua lundrës. Hoqi me një kanaçe ujin që kishte hyrë nga të plasariturat, u lëkund mbi të disa herë, rregulloi lopatat dhe zbriti.

Drita ra plotësisht. Mjegulla, duke u davaritur e duke u larguar gjithnjë e më shumë, i zbuloi shtëpitë e vogla të fshatit. Kozi hodhi sytë nga shtëpia e tij, të cilën vetëm ai mund ta dallonte, mes gjithë atyre kavakëve të lartë dhe iu duk sikur kishte ikur nga ajo para disa ditësh.

Nuk po i rrihej në një vend; një valë emocionesh nuk e linte të qetë. Mundohej ta përfytyronte kohën që u duhej djemve për të ardhur nga vendi i ngjarjes deri aty, dhe sytë i mbetën nga fundi i rrugës.

— Po sikur të jetë vrarë ndonjë?!... Jo, more, jo, se djemtë tanë janë të fortë.

Në drejtim të tij po vinte një njeri me vrap! Vetëm një ishte! Kur mendoi se nga gjithë djemtë mund të kishte mbetur vetëm ky që po vinte, u pre në fytyrë! Por jo!... Njeriu që vraponte drejt kënetës ecte i kërrusur; në një rën dorë mbante koburen dhe në tjetrën diçka të bardhë; pushkë s'kishte fare!... Njeriu vraponte shpejt drejt kënetës. Kur u afrua, harku i mustaqeve që lidhte cepin e buzëve me llapën e veshit, i kujtoi atij Xhaferrin, ballistin e njohur në tërë krahinën. Sa herë e kishin vënë në shenjestër atë kriminel dhe u kishte shpëtuar me dredhi; kurse tani po vinte vetë, si cjapi te kasapi. Pasi u bind se po vinte drejt lundrës, Kozi u shtri dhe mori shenjë. Mirëpo në çast iu zhduk nga sytë dhe nuk e pa më.



— Ndal!... Mos luaj! — i sokëlli Kozit pas shpine një zë i çjerrë, që dukej se dilte nga thellësia e gjoksit dhe shprehte njëherësh urdhër e frikë. Pa e prishur fare terezinë, Kozi ktheu kokën andej nga i erdhi zëri, e i qetë u përgjigj:

— E pse të luaj, a derëzi, kur s'luan këmbë njeriu për te lundra! Pse të luaj, kot?

Në vend të gjithë këtyre fjalëve ai mund t'i jepte si përgjigje vetëm një plumb. Por Xhaferri i kishte dalë pas shpine... Pastaj aty kishte ardhur për të pritur partizanët... dhe nuk e dinte akoma nëse ballisti ishte vetëm, apo me shokë. Po sikur të vinin edhe ballistë të tjerë pas tij?...

«Më parë duhet siguruar sa vetë janë, pastaj duhet vepruar shpejt, — mendoj Kozi. — Ndryshe, prishet plani dhe rrezikohen shokët». Edhe Spiroja kështu e kishte porositur!...

— Hajde, çohu në këmbë dhe kthehu këtej, se të vrava! — u ndie më i fortë zëri i ballistit. Tani Kozi e kuptoi se Xhaferri ishte pak metra pas shpinës së tij, fare pranë.

— Më duket se s'qenke udhëtar për lundërtarin, o zotëri! — tha Kozi. — Po unë për udhëtarët gdhitem e ngrysëm këtu, mes kallamishteve të kënetës; prandaj urdhëro e fol!

Pasi tërhoqi e mbërtheu përpara dy cepat e gunës, u ngrit, u kthye andej nga vinte zëri, por, për çudi, asgjë nuk po shihte.

— Hë! Trim i madh paska qëlluar! — tha Kozi me vete dhe sepse i erdhi për të qeshur. Pastaj foli: — Po qe për në lundër, mos u vono zotrote, se erdhi mëngjesi dhe...

— Mbylle gojën! Qen, bir qeni, se, për besë, ta zbrazta! More vesh, apo jo?!

— Doemos që e mora vesh xhanëm, por nuk po di kush është zotëria jote dhe kam frikë mos... dalim të njohur e turpërohem!

— Mjaft, lëri fjalët, o plak! Hajde, hidhi armët e griji duart lart! Kozi bëri sikur qeshi:

— Po ç'më duhen mua armët, o zotëri? Të bëj luftë me miskonjat apo me zhabat!? Arma ime është lopata e lundrës. Me atë, edhe në Itali të nxjerr unë me det!... — Tani e përcaktoi saktë se nga i fliste Xhaferri. Ishte strukur pas një zhuke. U ngrit përnjëherësh dhe, me koburen e drejtuar nga Kozi, klithi:

— Mos luaj!... Prapakthehu dhe shpejt zgjidhe lundrën!

— Po këto punë unë i bëj duke kënduar e jo me kobure, more zotëri! — dhe, duke zgjidhur zinxhirin e lundrës, ia nisi një këngë... me llërën e dorës shtrëngonte koburen pas brezit. I kryente veprimet sikur të mos kishte asnjë shqetësim. Po mendjen e kishte të djemtë! «Po sikur të vinin ata e ai të ishte në mesin e kënetës me këtë derr. Po sikur të mos i priste puna. Po sikur t'i diktojë Xhaferri e të ketë edhe shokë të tjerë përreth?»

Këto mendime i rrihnin si çekan mbi tëmtha. Megjithatë mendohej të dukej i qetë. Duke mërmëritur nëpër dhëmbë këngën, hipi në lundër, mori lopatën, hodhi edhe një herë sytë nga rruga e fshatit, pastaj i foli ballistit, i cili herë-herë kthente kokën anej nga erdhi. Fodullëku dhe qetësia që filluan të dukeshin tek ai tregonin se u bind që nuk e ndiqnin nga pas.

— Urdhëroni zotëri! Pas pesë minutash jemi në bregun tjetër! — tha Kozi.

Xhaferri, sikur të kishte pritur llafin e tij, iu shkreh:

— Hajde, mbylle gojën! Gjidi leckaman! Dhe mbylle të thashë, se, për besë, ta zbrazal... Oj, derri i derrit. Po si, more, si të këndohet sot? Eëëë? Sikur të jetë ditë feste e jo zie! Po a e di ti se ç'ndodhi sot, more derr?! Eëëë? E di apo s'e di, xhanëm! — e ndryshoi tonin Xhaferri, sikur do t'i thoshte Kozit diçka për të cilën edhe ky do të mallëngjehej së tepërmi.

— Gjynah mos qoftë, zotëri, po ku di gjë unë, i shkreti! Po hë, ç'ndodhi?

— Hë, hë! Ç'ka ndodhur, ëëë? Hiç s'ke dëgjuar gjë ti, hiç fare? Eëëë?

— Po kë të dëgjosh këtu, zotëri? Këtu vetëm zhabat e miskonjat dëgjon... Atyre s'ua dimë gjuhën...!

— Lëri dënglat, të thashë, more vesh? Dhe mba-je mend këtë ditë; është ditë zie! Na u vranë komandanti gjerman dhe komandant Hyseni, balli i trimave të këtij kombi!... Na i vranë të poshtërit... Na i vranë ata lapurakët e malit, që veç mos më rënçin në dorë, se... — dhe në fytyrën e kuqe të Xhaferrit rrokulliseshin bulëza që nuk merrej vesh nëse ishin lotët për komandantin, apo djersët që i kishin dalë nga vrapi që kishte nisur për të mos pësuar fatin e komandantit...

— Jo, more! Oh, të shkretën, ç'na paska gjetur! — bëri sikur shprehu keqardhje Kozi.

— Hajde tani, nise lundrën shpejt! Komandant Hysenit i duhet marrë haku! Nise lundrën dhe mbaj zi për komandant Hysenin... — Xhaferri nxori shamënë e fshiu fytyrën e dhjamur. Kozi vazhdonte t'i lëvizte lopatat më me shpejtësi, duke mërmëritur gjithnjë këngën nëpër dhëmbë.

— Epo pusho, de! — iu hakërrua prapë Kozit Xhaferri me kobure më dorë, pasi priti një copë herë duke e shikuar në sy.

Kozi ia nguli sytë me një farë habie që të bënte për të qeshur, dhe ai diktoi në fytyrën e lundërtarit talljen dhe gëzimin. Kjo e tërboi më shumë.

— Pusho, të thashë, qen bir qeni; se, ta di që vërtet nuk të vjen keq, këtu t'i zbraz zorrët e të lë top në vend, me zhabat...!

— E si të mos më vijë keq, kur zotrote thua se vdiq. Po si ta qaj s'më tregove zotrote... — tha Kozi duke e mbajtur me zor të qeshurën dhe duke lëvizur lopatat. I futi thellë, që të merrnin sa më shumë ujë dhe, kur arriti në mesin e kënetës, u bind se ballisti ishte vetëm. Ky mendim iu duk sikur e lehtësoi, siç lehtësohet njeriu që, pas shumë hamendjesh, merr një vendim të rëndësishëm.

— Hajde de! Gjidi lapangjoz... Oj, për të kënduar ditke ti; për të qarë trimat që bien në fushën e luftës, jo! Ëëëë?

Sytë e Xhaferrit ishin skuqur më shumë; dora që mbante koburen i dridhej nga inati dhe djersët vazhdonin t'i iknin çurg. Të dy qëndronin në skajet e kundërta, përballë njëri-tjetrit.

— Ne nuk dimë të qajmë! — thirri Kozi dhe më tej nuk qe nevoja të zgjatej.

Një kthim djathtas i lundrës me shpejtësi, bëri që Xhaferrin të kërcente nja dy metra larg saj, në ujin e ftohtë e të zverdhur të kënetës. Koburja i ra nga dora. Kur Xhaferrin po mundohej me duar e me këmbë të dilte në sipërfaqe, koburja e Kozit u shkreh për së treti herë. Uji rreth e qark u skuq.

— Gjarpër i ndyrë! Aty merrja hakun komandar Hysenit! — tha Kozi. Dhe, duke buzëqeshur, shtoi: — Ti vërtet je gjarpër, po unë jam zhabë...

Në çast ndjeu t'i lageshin këmbët. Lundra kishite marrë ujë. Iu vu punës dhe me kanaçe hoqi aq ujë,

sa të shmangte rrezikun e mbytjes. Pastaj e ktheu lundrën drejt bregut. Pa arritur në zall, dëgjoji she-njën që dikush e jepte nga larg. E lidhi lundrën dhe shikoi andej nga vinte shenja. Me një ndjenjë të ma-dhe gëzimi, ua nguli sytë njerëzve që vinin duke ecur shtruar, sikur të ishin udhëtarë të zakonshëm. Herë-herë jepnin shenjën duke vërshëllyer.

Sapo panë Kozin, ata nderuan me grusht. Edhe lundërtari i përshëndeti duke ngritur koburen lart dhe duke e tundur sa majtas-djathtas. Ishin ata që priste. Pasi u afruan edhe ca, në krye pa Spiron. Ecte i qeshur, me gaz në sy e në zemër. -

Nga majat e kodrave të Ardenicës po zbrisnin tu-fa rrezesh të ngrohta-dielli. Pas pak ato u shtrinë në gjithë fushën e paanë e të përgjumur të Myzeqesë.

— Dukesh ca i lodhur, o xha Kozi, — i tha Spiro-ja.

— M'u desh të shpie matanë Xhaferrin, o Spiro...

— Ku e çove?

— E çova të gjejë komandant Hysenin. E shikon, ja si lëkundet në mes të kënetës!

— Të lumtë, o Kozi! E kreve detyrën tamam si partizan.

Kështu tha Spiroja dhe e përqafoi xha Kozin. Pas tij e përqaftuan edhe të tjerët.

O BURRA, SE NA ZURI MËSUESJA!

— Filloi ky! — e shtyu me bërryl Neta mësuesen e muzikës, Zanën. Dhe duke zhvendosur harkun e vetullave sa poshtë, lart, i tregoi shoqes drejtorin, që nisi të fliste.

— Përsëri kemi ndonjë nxënës që nuk paraqitet në shkollë, përsëri kemi ndonjë nxënës që mungon në orë të veçanta në mësim!...

Problemi ishte shqetësues, ndaj drejtori e gjithë mësuesit e tjerë me të drejtë filluan me zjarr diskutimin. Po afronte fundi i semestrit dhe dy mësueset ende nuk po i hante merakun për dy-tre nxënës, që i njihnin vetëm nga emri në regjistër.

— Epo, sikur s'mban më ujë pilafi! — i pëshpëriti shoqes Zana. — As nuk kemi ç'themi! Mjaft e kemi vërtitur, tani nuk e dredhim dot më.

— Fajin e kanë vetë ata dy-tre nxënësit... Fundja, pse nuk vijnë të klasifikohen tani në fund të semestrit të paktën? — iu përgjigj Neta pak e nxehur. — Ç'bëjnë prindët e tyre? Po këshilli i fshatit?

Drejtori atë çast tha:

— Ç'bëjnë mësueset e lëndës për këta nxënës?

Neta me Zanën nuk u ndien.

Të shtyra nga vërejtja e drejtorit, ato vendosën të niseshin. Pasi i shikuan edhe një herë emrat e prindërve të nxënësve në regjistër (që të pyesnin rrugës se ku i kishin shtëpitë), u nisën përmes arave, në drejtimin që u thanë kolegët vendas. Se, që ta dini edhe ju, mësueset në fjalë i kemi mysafire nga qyteti. Prandaj, sa herë flitet për punë a ndodhi në ndonjë lagje a brigadë të kooperativës, ne nuk harrojmë t'i orientojmë shoqet tona, që të përcaktojnë mirë kuadratin ku ndodhin ngjarjet. Veçse duhet eksperiencë dhe kujdes i madh... Në qoftë se nuk do bazohesh në objektet e njohura prej tyre, zor se do arrish t'i orientosh shoqet tona qytetare. Ndaj né, që e njohim mirë rëndësinë e së njohurës, për të arritur tek e panjohura, e fillojmë këtë punë me objektet e pakta që ato kanë mundur të njohin në fshatin ku punojnë prej dy vjetësh si mësuese. Kështu për shembull, e fillojmë me stacionin e autobusit, ku ato zbresin çdo mëngjes, dhe e vazhdojmë me mensën e kooperativës, ku drekohen para nisjes. Në fakt fshati është i madh dhe ka shumë objekte që mund t'u shërbejnë atyre si orientuese, siç janë shtëpia e kulturës, lavanteria, qendrat e brigadave, etj., etj., po, kur s'të lidh puna me to, s'ke edhe si t'i dish... sidoqoftë, ato sot u nisën.

Duke soditur natyrën e bukur dhe grunjërat që zverdhonin deri larg, vunë ré shtëpitë e fshatit fqinj, ku, sipas thënieve, banonin edhe ata dy nxënësit e tyre. Rrezet e vakëta të diellit të pasditës binin pjertras në shtëpitë e bardha të kooperativistëve.

Në të djathtë të rrugës lartohej një kodër, të cilën sapo kishin filluar ta shpyllëzonin. Andej dëgjuan të vinte një melodi e njohur baritore, që shpesh ndër-

pritej e shoqërohej me të fishkëllyer. Mësuesja e muzikës, Zana, që po e dëgjonte me vëmendje, dalloi në atë kompleks melodish aftësi të veçanta interpretimi.

— Ja! — i tha shoqes. — Kjo është ç'është! Orë të tëra lodhesh në klasë dhe nxënësi mezi të nxjerr një melodi, kurse këtu këndon si bilbil, pa i thënë njeri fare... — Dhe, të tërhequra nga melodia e kureshtja, filluan të ecnin djathtas, drejt lëndinës. Prapa disa kaçubave, me melodinë e këmborëve përzihej edhe kënga e një djaloshi me sy të kaltër.

Sapo e pa, mësuesja e muzikës njohu menjëherë nxënësin e saj, Jotin!

— Shiko, shiko! — iu drejtua ajo Netës. — Joti, moj, Joti im!... Dhe as që dashkërka t'ia dijë që unë për të po ngjitem deri këtu!

— Dëgjoje si ia paska marrë për shtatë palë qejfe! ia priti Neta. — Dhe ti thua se Joti nuk kalon në muzikë! Di ç'të bësh ti, shtyje tutje, se muzikë është! Apo ke frikë se s'do të dijë të mbajë iso e të bëjë ka-ba...

— Mirë më thua, moj motër, s'kam pse të vij më tej. Unë e klasifikova që sot, këtu! Me këtë zë që paska, ai mund të këndojë më mirë nga gjithë ata që vijnë në përditë në klasë. Unë e bëra detyrën, — dhe shpallosi një gazetë, që e kishte marrë për ta shtruar kur të ulej.

Neta e shikoi vëngër, sikur donte t'i thoshte:

— Ama shoqe! Po mua ku do të më lësh?

Ndërkohë, Joti, pasi u bind se cilat ishin ato që po vinin drejt tij, u sul i kërrusur nëpër kaçuba dhe dha alarmin:

— Xhevit! O Xhevit! Mësuesja, ore, mësuesja! Imja dhe jotja; po vijnë këtej!... O burra, se na zunë! Xheviti, që po luante me një grup fëmijësh, u

habit. Ai kishte qenë në shkollë aq ditë, sa e kish njohur mësuesen kujdestare, prandaj nuk i besohej. Mësuesja e tij këtu?!

Shikoi shokët dhe u sul me Jotin, nga ana tjetër e kodrës, me të katra.

Mësuesja e fizkulturës, sapo dëgjoji që thirrën «Xhevit», kuptoi se po i flisnin nxënësit të saj, Xhevit Begajt, për të cilin ishte nisur. Nxitoi ta thërriste e të bisedonte me të, por mundi t'i shihte vetëm opinjat nga pas, që e rrihnin në vithe nga vrapi që kishin të zënë...

Duke ecur në gjurmët e nxënësve, që u humbën nga sytë, u gjendën para një kanali nja katër metra i gjerë. Ndërsa Zana po kërkonte të gjente një vend më të ngushtë për të kaluar, kolegja e saj e fizkulturës thirri tërë gaz:

— Ju lumtë, more nxënës!... Ja, kësaj i thonë kalitje!

Zana po habitej me gëzimin e shoqes.

— I sheh ku janë hedhur, apo jo? — i tregoi tjetra gjurmët e nxënësve. — Tani unë ta kalova ty, me gjithë atë Jotin tënd. Kanali është mbi katër metra i gjerrë kurse normativa për këta nxënës nuk i kalon as tri metra e gjysmë. E shikon pra?! Nga stëvitja e tepërt, edhe rekorde kanë arritur të thyejnë në kërcim së gjati. Epo kësaj i thonë punë, — përfundoi e kënaqur mësuesja e fizkulturës, që më në fund ia kaloi edhe shoqes së saj të muzikës në kryerjen e detyrës... — Sikur t'ua njihja më parë shkathtësinë këtyre nxënësve që u hodhën këtu, me siguri do ta kisha ngritur ekipin e shkollës. Kurse për Xhevitin as që ia vlen të diskutohet më tej. Fare të mos vijë, ai fizkulturën e mori sot!

— Epo atëherë të kthehemi, ç'do të bëjmë më tej?

— tha tjetra. — Ne për këta dolëm. Se na lë dhe autobusi!...

— Këtyre tani t'u plotësojmë dëftesën e t'u përgatitim karakteristikën... Apo jo?

— Mbaruan mësimet thuaj... mbaroi viti shkollor!

— Në fillim të vitit këta nxënës nuk ishin kësh-tu! Të kujtohet sa të rregullt kanë qenë? Vinin çdo ditë, mësonin mirë... pastaj nuk erdhën më rregullisht.

— Pse nuk erdhën, akoma s'e kam të qartë...

— Kollaj fare. I lamë ne në harresë!

Aty buzë kanalit i kujtuan njëra-tjetrës kritikat e ashpra që u kishin bërë sa herë shokët për këtë çështje.

Në fillim ishin munduar ta bindnin kolektivin se këta nxënës ishin të pandreqshëm dhe se u ishte zbehur dëshira për mësimin e fizkulturës dhe të muzikës. Mirëpo mësuesit e tjerë, që i njihnin prej disa vitesh, njëzëri ua kishin hedhur poshtë këto pretendime:


— Këta nxënës i duan lëndët tuaja si gjithë shokët e tyre! — kishte thënë i nxehur mësues Ganiu, më i moshuari i tyre.

— Dhe pyetjen: *pse ata u larguan nga shkolla pikërisht sivjet, që janë nën kujdestarinë tuaj*, — shtoi Vita, — duhet t'ia bëni vetes.

...Ja afërsisht kështu kishin diskutuar edhe të tjerët.

— Hëë moj goca, s'po e kaloni dot, ëë? — i ndërpreu xha Todi me zërin e trashë, i cili i kishte vënë aty buzë kanalit dhe u afrua t'i ndihmonte. — Kalohet, kalohet; po do një çikë vrysh, se bie brenda! Apo s'mban edhe ujë, i uruari...!

Ato e shikonin pa ditur ç't'i thoshin. Ai futi përsëri llullën në gojë dhe filloi të tymosej. Të dyja më-



sueset i kujtuan kohën kur në fshat vinin të deleguara; hynin shtëpi më shtëpi, bisedonin me gratë e burrat për kooperativën e porsakrijuar apo me ndonjë shoqe që nuk dilte rregullisht në punë. — Eëëëë, — pyeste xha Todi veten;— edhe këto nga qyteti të jenë, xhanëm?! Po, po! Dhe vijnë për konferenca... — Dhe, sikur të ishte kujtuar për diçka, i pyeti të dyja mësueset: — Atje te brigada do të vini ju? — e tregoi me bishtin e llullës një grup kooperativistësh që po punonin poshtë në arë. — Qenë dhe ca çunakë këtej, po sepse u tremben! Dy nga ata zbritën tatëpjetë; të tjerët po ju presin atje...

— Jo, xhaxho, jo!... Ne deri këtu e kishim punën! — thanë pothuajse në një gojë të dyja mësueset dhe, pasi shikuan orën e dorës, morën kthesën!

— Natën e mirë, xhaxha! — përshëndetën pa kthyer as kokën sikur të kishin frikë ta shikonin plakun në sy.

— Natën e mirë! — u përgjigj edhe ai, pasi pa nga dielli që akoma s'e kishte filluar tatëpjetën për në det. Dhe duke i shikuar tek largoheshin përmes fjollave të tymit, që ngriheshin nga llulla, shtoi me zë të vrazhdë: — Ju qoftë rruga e mbarë! Po sikur të kishit guxuar ta kalonit kanalin, moj çupa, nuk do të kishit bërë keq.

GJUEKTA E FUNDIT E DHASKAL DHIMOJA

Atë ditë që erdhi dhaskal Dhimoja, në fshat u bë një festë e vërtetë. Fshatarët kishin dy vjet që i bënin kërkesë qeverisë dhe prisnin të vinte mësuesi. Dhe ja, ai erdhi vetë në një ditë të vrenjtur të vjeshtës së vonë. Për këtë kryeplaku kishte tri ditë që ishte njoftuar dhe i mbante shtruar shiltetë në odën e miqve. Njeriu që do të vinte si mësues, nuk ishte dosido. Njerëzit e tij hanin bukë me të parët e mbretërisë dhe, brez pas brezi ngrohnin kolltukët e saj. Edhe ai vetë rridhte po nga ky soj. Mirëpo ndërsa gjithë njerëzit e tij kishin zënë kolltukë, nga ku bënin emër, Dhimoja, si për turp të fisit, disa herë kishte hedhur baltë mbi atë soj e sorollop të dëgjuar. Të gjithë ishin munduar ta vinin në një punë të nderuar e me një rrogë të majme apo ta futnin në ndonjë shkollë të lartë, po Dhimoja mbeti ai që qe. Në asnjë vatrë s'i piqupte dy bukë bashkë. Mësoi vetëm shkrim e këndim që kur ishte fëmijë, se ndryshe kishte për të mbetur qorr me sy hapët. Të afërmit shqetësoheshin edhe për një gjë tjetër. Dhimoja i ishte përveshur me të dyja duart pasurisë që trashëgonte nga të parët dhe po e bënte rrush e kumbulla. Dhe, siç e kishte nisur, një ditë do të mbetej me gisht në gojë.

Dëfrimet e Dhimos me shokë nëpër kabare e mejhane, shpeshherë ishin kthyer në gjullurdura që kishin tronditur tërë qytetin e kishin vënë në lëvizje njerëzit e tij, për ta shpëtuar nga burgu disa herë. Këto ishin arsyet që njerëzit e tij ranë në ujdi me qeverinë e me kryeplakun e fshatit tonë për ta dërguar mësues te ne, pasi morën vesh kërkesën tonë të përsëritur disa herë.

«Fundja, shkrim e këndim di Dhimoja, — menduan ata, — dha deri në veshin e këtij fshati të largët mbase nuk kanë shkuar zullumet e tij». Dhe në të vërtetë fshati as emrin dhe as «trimëritë» s'ia kishte dëgjuar Dhimos. Prandaj, kur erdhi në fshat, u shkullën të gjithë, sikur të zbriste nga ai kalë murrash një burrë shteti e jo Dhimoja. Turmës së fshatarëve as që begenisi t'i hidhte sytë. U përçafua me kryeplakun, për të cilin kishte sjellë porosi e nderime të posaçme dhe me postkomandantin, që kishte ardhur kastile për ta pritur.

Kishte bërë rrugë të gjatë e të vështirë prandaj dukej i lodhur e i mërëzitur. Ecte duke u lëkundur sa majtas, djathtas dhe fliste rrallë me kryeplakun e me postkomandantin. Pas tyre ecte bekçiu i fshatit, duke tërhequr frerën e kalit me shalë. Më pas vinte vargu i gjatë i fshatarëve, të cilët mbetën duke pyetur njëri-tjetrin, si do të bëhej për librat, ku do të vendosej shkolla, si e kishte emrin mësuesi e të tjera. Shumë herë ia kishin bërë këto pyetje edhe kryeplakut, por ai i binte shkurt:

— Unë s'jam dhaskal; kur të vijë dhaskali, ai i di këto punë dhe do t'jua thotë!

Tërë ajo darkë kaloi me gëzimin e shkollës në çdo shtëpi; fëmijët u fjalosën me prindërit se kush do t'i ruante bagëtitë të nesërmen...

Mirëpo prapë s'qe e thënë... Bashkë me rrezet e e para të diellit të së nesërme u përhap edhe lajmi se dhaskali paskësh gdhirë i sëmurë, pa qejf! Sidoqoftë, dikur ai u bë esëll dhe doli. Majë kalit, të dy me kryeplakun, shëtitën një pasdite tërë fshatin. Më në fund edhe fshatarët bënë si bënë dhe e rregulluan ndërtesën e shkolla filloi: Shkollë i thënshin, se kryeplaku rregulloi vetëm një tavolinë e një karrige për mësuesin, kurse për nxënësit tha:

— Kush të dojë të ulet, të sjellë me vete nga një fron! Secili për vete mëson!

I uroi Dhimos punë të mbarë, caktuan orën e pasditës për gjah dhe iku.

Kështu e filluam mësimin me dhaskal Dhimon. Ata që e njohën apo që provuan mbi shpinë huqet e tij, e kujtojnë, përveç të tjerave, edhe për gjahun e mbarë që bënte. Dukej sikur ai kishte ardhur në këtë botë për të lënë gjurmë të pashlyera në dy fusha të veprimtarisë shoqërore: në atë të pijeve dhe të gjahut. Qejfli të atillë gjahu e rakie nuk ka njohur, jo më fshati ynë po tërë nahija. Çdo mëngjes ai futej në klasë me çiftin dhe çantën në krahë. Pasi ulej dhe mbështeste çiftin në tavolinë, urdhëronte:

— Shpejt, Nase, se na iku mëngjesi!

Nipi i bekçiuat e dinte detyrën: merrte çantën e mësuesit, nxirrte që aty mezen (një zog a turtull të skuqur; i butë a i egër s'prishte punë) dhe ia shtronte në tavolinë. Nxirrte edhe shishen dhe, pasi rregullonte çdo gjë, ulej në vendin e vet. Kur shishja ishte përgjysmë, Naseja e mbante një hop në dorë dhe shihte të zotin sikur donte ta pyeste me sy.

— E ç'më shikon ashtu? Radhën! — ulërinte Dhimoja pa i ngritur sytë.

Ai që kishte radhën e dinte: me shishen në dorë

vraponte për në shtëpi. Pasi sillte rakinë, i mbante sytë nga tavolina se mos i mbarohej mezja zotnisë! Kishte radhën atë ditë!

Kështu mësuesi vazhdonte punën e tij në tavolinë, dhe nxënësit të tyren. Që të mos i hamë hakun, duhet të themi se kjo punë fillonte pasi mësuesi ua kishte treguar se në cilën faqe e cilën temë do të lexonin. Në fund i pyeste me radhë.

Ne nxënësit çoheshim në këmbë dhe thoshim përmendësh ç'kishim mësuar.

Mësuesi, serioz e duke gogësitur, mbante përpara librin dhe purtekën. Ndiqte me sy në libër atë që thoshte nxënësi dhe, po të linte gjë mangut, me dorën e djathtë ngrinte purtekën. Fëmija afrohej duke u dridhur dhe dëgjonte këto fjalë: — Të djathtën! Pesë! — Pastaj shtrëngonte dhëmbët e hidhej përpjetë me sy të përcërruar nga dhembjet. Sikur të mos i duronte dhembjet e ta mbyllte shuplakën, e paguante më shtrenjtë akoma. Dhimoja, që nxehej duke goditur, gulçonte tërë djersë: — Të majtën, derr! — Dhe në shuplakën e majtë përplaseshin edhe pesë thupra të tjera, të shoqëruara nga gulçimet e dhaskalit. Po kusuret shtoheshin kur thupra thyhej në «punë e sipër.» Në raste të tilla mësuesi vazhdonte me inat të dyfishuar, me pjesën e thuprës që i mbetej në dorë, derisa ajo të bëhej copë e çikë. Në këto raste, rreziku më i madh ishte se thupra mund të mernte edhe nga koka e të të nxirrte ndonjë sy...

Prandaj gjëja që mësuan më mirë fëmijët nga dhaskal Dhimoja, ishte zotësia dhe aftësia e tyre për të kuptuar drejtimin e dorës së tij dhe shkathtësia për t'iu shmangur goditjes së lirë nga një dorë e fuqishme dhe e stërvitur.

Pas këtij procesioni, niste ai i sharjeve, të cilat

fillonin që nga nxënësi deri te katragjyshi i tij. Këto tani i takonin gjithë klasës, kurse fajtori që thente thuprën e dinte urdhrin. Merrte vrapin drejt kodrës së Ardenicës, për ta zëvendësuar atë që theu me pesë të reja. Ishin të rralla ditët kur së paku një nxënës të mos shkonte në shtëpi me duar të enjtura gjak ose me ndonjë çyrykllëk tjetër.

Me gjithë këto huqe, dhaskali ua kishte prurë shpirtin fshatarëve në majë të hundës dhe, pa shkuar shumë kohë, disa filluan t'ia gdhendnin drurin...

— Dëgjo këtu! — i ishte ankuar Gaqi me shokë kryeplakut një mbrëmje. — Po më erdhi edhe një herë djali i rrahur në shtëpi, ose të ngulë këmbë se nuk shkon në shkollë pa meze e raki për dhaskalin, i thuaj Dhimos se do t'i japim ne një meze që ta mbajë mend gjithë jetën. Ja kështu!

Po Gaqi s'ishte i pari që ankohej për Dhimon. Të tjerë gati ishin rrahur me të edhe në klasë. Disa kishin kërkuar t'i futnin një dru e ta përzinin fare nga fshati.

— Më mirë pa të sesa me një pijanec e katil të fëmijëve! — thoshin disa nga fshatarët.

— Po do të na mbeten fëmijët qorra përjetë, more shokë! — qaheshin të tjerët.

— T'i themi edhe një herë kryeplakut, mbase i heq një çikë veshin...

Dhe shkonin prapë te kryeplaku e i qaheshin. Po veshët e dhaskalit nuk i arrinte dot kryeplaku... Bile as që ia mbante t'ia zinte me gojë këto gjëra dhaskalit, megjithëse e shihte me sytë e tij që prapësitë e Dhimos e kalonin kufirin.

Kur mësuesi ishte në punën e tij në tavolinë, tur-tujt vinin e qëndronin, si për inat të tij, në degët e manit, te dritarja e klasës. Atëherë Dhimoja e shih-

te më të arsyeshme ta ndërpriste përkohësisht punën në tavolinë, rrëmbente dygrykëshen dhe palosej pas dritares. — Bam! Bam! — kërciste çiftja dhe shpeshherë ndodhte që t'i vriste zogjtë. Naseja vraponte e ia sillte:

— Urdhëro zotni, të dy (apo tri, sa të ishin).

— Unë s'jam buf që t'i ha pa pjekur! Ai që ka radhën t'i skuqë me gjalpë: — Dhe pas një ore, ai që kishte radhën ia sillte ashtu siç i kishte hije një dhaskali si Dhimoja.

Ndodhte ndonjëherë që zagaret e fshatit të vinin përpara ndonjë shokun e tyre të panjohur mirë dhe ta ndiqnin ferrë më ferrë duke lehur.

— Lepuri!... — ia bënte vetëm një herë. Dhimoja e sakaq ia zinte shtegun me gishtin në këmbëz. Po ndodhte që shtegu të ishte larg një apo dy orë. Atëherë Naseja fuste në çantë ato që kishin mbetur në tavolinë, ia hipte kalit dhe shkante andej nga lihnin zagaret. Andej mbetej deri në darkë. Naseja ndiq Dhimon, Dhimoja ndiq zagaret, zagaret ndiqnin shokun e tyre, që Dhimoja e merrte për lepur! Aq shumë ishte dashuruar pas mishit të lepurit dhaskali, sa që, sikur të paskësh mbetur edhe pak kohë kësaj ane, këmbë lepurit nuk do të kishte lënë.

*

* *

...Ishte pasdite. Në krye të lëndinës u dëgjuan të lehura zagareësh. Ndërsa Bekçiu futi zagaret në fund të lëndinës, Dhimoja me njëren dorë në jele të kalit e me tjetrën në dygrykëshen, u nis t'u zinte shtigjet lepujve.

Sifi, nxënësi i tij dhjetëvjeçar, që po ruante ato

dy dhi që kishin, ishte struktur pas një zhuke dhe e pa shumë afër Dhimon. Nxënësi i gjorë, që kishte dalë dy herë i enjtur nga duart e dhaskalit, edhe natën në gjumë trembej prej tij. Duke menduar se Dhimoja do të kalonte andej nga lidhnin zagaret, Sifi u fut në këmbadoras nën një gëmushë, u mbështoll kruspull me gunën e leshtë dhe as frymë nuk po merrte. Dëgjonte të lehurat e zagareve që po i afrosheshin gjithnjë e më shumë. Diku afër dëgjoi patkonjtë e kalit, po vetëm për një çast, se pastaj sikur qëndruan. Zagaret pothuajse po i hipnin sipër duke lehur.

Në këto e sipër dëgjoi diçka që buçiti shumë fort dhe fare afër tij... Vetëm kaq dhe asgjë më! Dhimos, sapo u bë gati të zbrazte grykën e dytë, sa s'i ra çiftja nga dora dhe u bë esëll; gjithë ajo raki e drekës iu bë ujë. Kishte qëlluar mbi fëmijën!

Sifi i gjorë dha kujën dhe mori të ngrihej, por ishte e kotë! Mësuesi, me fodullëkun që e karakterizonte, iu çor:

— Po ti, more, ç'do aty?

Sifi ra përsëri e s'po ndihej më. Edhe zëri po i mekej. Dhimoja e mblodhi veten, u zverdh e u tmerrua, kur kujtoi se kishte qëlluar me çifte e jo me thupër... U sul mori djalin, të cilit ia mbuloi gjaku kofshën, dhe e ngriti në krahë. Në këtë kohë mbërriti aty bekçiu. Gazi e gëzimi për gjahun e majmë iu kthyen në frikë e lemeri.

— Ç'paske bërë kështu, more, more...! — dhe u sul e rrëmbeu vetë fëmijën. E zhveshi, ia zuri plagën me duhan e ia lidhi duke i ndaluar hemoragjinë. Pastaj shikoi përreth, sikur të kërkonte mendimin e dikujt për çka duhej të bënte më tej.



Njëqind metra larg pa të vraponin drejt tyre katër burra e një grua. Dhimoja shikonte me sy të çakërritur herë atë e herë fëmijën dhe mbeti si hu gardhi.

— Është e ëma, o i zi! Zhduku, se me thonj do të të mbytë! — i tha bekçiu. Dhimoja sikur u zgjua nga gjumi, rrëmbeu çiftin, iu vërvit kalit sipër dhe mori vrapin në anën e kundërt të fshatit, në drejtim të pyllit.

Kur panë të plagosurin ata që erdhën të parët, e mbërthyen bekçiun nga zverku, e vunë poshtë dhe e qëlluan me se mundën. Ai mezi u tregoi me dy fjalë ngjarjen dhe Dhimon, i cili dukej sa një lëmsh mbi kalin që vraponte drejt pyllit. Nëna rrëmbeu Sifin dhe u nis drejt fshatit me plot të tjerë. Dhjetëra njerëz sikur mbinë nga dheu sa të hapësh e të mbyllësh sytë. Gjysma iu sulën Dhimos me sfulqe e hunj. Ai që ishte afruar më shumë kishte çiftin e bekçiut. Qëllloi një herë po ishte larg. Vrapoi përsëri, qëllloi dy herë radhazi dhe priti. Kali eci vetëm dy-tre metra më tej, pastaj ai burrë i bërë grusht mbi të u shemb poshtë si një thes...

Kjo ishte gjuetia e fundit e dhaskal Dhimos në fshatin tonë.

PLEQËRIA

Muhabetet për fejesën e Florikës shtoheshin e merrnin përpjetë, sa herë që në fshat zbriste ndonjë specialist a punonjës me rëndësi nga qyteti.

Të nesërmen e mbërritjes së tij Florika do të bënte si do të bënte e do ta gjente mënyrën për të këmbyer me të dy-tri llafe, sa për prezantim, apo do t'i kalonte disa herë para syve. Sepse ishte e pamundur ta shihje së pari Florikën dhe mos të të tërhiqte vëmendjen. Trupi lastar e i mbushur, harku i vetullave si pendë korb, bukuria e të cilave dallohej që larg, sytë e shkruar që të bënin për vete që në shikimin e parë dhe sidomos shija e hollë dhe tepër elegante në të veshur, ishin disa nga cilësitë me të cilat Florika mburrej para gjithë botës.

Por reklamin më të madh të cilësive e kishte marrë përsipër ta bënte vetë e ëma, së cilës, kur shihete atë deli çupë, i dukej se nuk kishte lindur katër të tilla por vetëm një, Florikën!

Vërtet që kishte rritur e martuar edhe tri të tjerë, por kjo e vogla ua shkonte të gjithave, në daç për trup, në daç për tru...

Kështu u krenohesh shpesh e ëma bashkëfshata-



rëve. E dridhte nga e dridhte muhabetin dhe me te-rezi u shtonte gjithë këtyre cilësive edhe diplomën e mësueses që kishte Florika. Kështu, nga llafi në llaf, çmimi i çupës rritej... Kur Florika i kishte thënë se inxhinieri nuk mund të merrte një vajzë fshatare, e ëma ia kishte pritur:

— Hajt ti, hajt! Është djalkë ai! Ujdise ti sa të ma sjellësh një herë në shtëpi, pa, po e vura një herë në qoshe, di unë si e dredh dhe ia prish mendjen atij.

...Dhe kjo ditë nuk vonoi Pasi ia përsëriti ndoshta për të dhjetën herë lutjen që t'i vinte në shtëpi se i ishte prishur lavatrici dhe po hiqte pikën e zezë. inxhinieri u bind (ose më mirë u zu ngushtë) dhe erdhi një pasdite në shtëpinë e Florikës, me pinca e kaçavidë në dorë. Gjëja e parë për të cilën mendohet rrugës, ishte habia se si u bind të shkonte në këtë shtëpi për një gjë kaq të vogël. Ai kishte rregulluar stalineca, ekskavatorë e autokombajna, por të

shkonte për të ndrequr një lavatriçe, që nuk futej fare në zanatin e tij të drejtpërdrejtë... Nejse! Ai e kuptonte se lutjet e Florikës binin erë sebeb...

Habinë e dytë e pësoi kur po shkonte rrugës për në shtëpinë e Florikës. Hidhte sytë majtas e djathtas dhe ngado shihte njerëz që kishin dalë te porta, te dera e nëpër dritare dhe u ngulnin sytë, sidomos atij, sikur të ishte një kafshë e rrallë.

— More, po sa shpejt e mpleksi! Azgan qenka. ëë?

— Sa mirë përpjekin, moj korbë! — shtonte një plakë më tej.

Këto i dëgjonte edhe ai, ndërsa ecte duke biseduar me Florikën për gjëra fare pa rëndësi. Sa herë u përplasej në vesh ndonjë fjalë e tillë, Florika e shikonte inxhinierin me bishtin e syrit dhe një buzëqeshje e ngrirë, me një pikëpyetje të pafund, i shtrihej në gjithë fytyrën! Kështu arritën deri te porta e shtëpisë.

Këtu pësoi habinë e tretë e më të madhen inxhinieri. Kishin dalë për ta pritur aq shumë njerëz, sa që ai u ndodh fare i papërgatitur përpara asaj ceremonie.

Pasi u përqaftua nga të gjithë ata, sikur të ishte djali i tyre e të kthehej nga nizamllëku (me më tepër se gjysmën e tyre as që ishte parë ndonjëherë...), i futën krahun dhe e ulën në kolltukun e butë të dhomës së pritjes. Gjithçka gjendej përreth i dukej sikur ishte sjellë aty për të plotësuar ambientin solemn të përgatitur për të. Menjëherë Florika vuri përparësen e bardhë, që ai kishte qëndisur aq bukur e ëma për raste të tilla, u pa dy-tri herë në mënyrë dhe u paraqit tërë nur e buzëqeshje në dhomën e miqve. E gostiti mikun me fërnet e me llokume dhe në konfi-

dencë e pyeti nëse donte kafe apo kakao, dhe si e pinte.

— Ju falem nderit, po unë asgjë nuk pi...! — tha ai, i zënë ngushtë, me sytë te pincat e kaçavida.

— Ah, jo, jo! Diçka domosdo do të pini, se...! — e zonja e shtëpisë deshi të shtonte «se mezi të pamë në shtëpi», po iu duk i nxituar ky mendim dhe e la për më vonë.

— Mirë, një kakao! — tha ai, duke iu përgjigjur njëkohësisht edhe syve të Florikës, që priste në këmbë.

Sakaq ajo fluturoi në kuzhinë, ndërroi xhezvenë me një më të madhe dhe e vuri mbi furnelë. Ndërkohe, e zonja e shtëpisë, pasi bëri gjenealogjinë e familjes së saj, filloi ta pyeste mikun:

— Zotrote jeni nga qyteti?

— Po! — u përgjigj ai fare ftohtë.

— Ee! Kështu më ka thënë edhe Flora!... Po ç'njerëz keni në shtëpi?

— Kam nënën dhe një motër në shkollën e mesme bujqësore!

— Epo mirë, mirë! Paske plot shyqyr! Po nëna të mbahet ndopak apo jo? — dhe qeshi me djallëzi. — Tashti që fillove punën, çoji edhe një nuse nënës në shtëpi dhe ik me mendjen të mbledhur! Se ne plakat kështu e kemi; hyzmetin e fjalën e mirë duam; pa për gjë tjetër s'jemi më ne!... Apo e kam keq, more bir? — deshi të dinte plaka mendimin e tij për ato që tha.

— Ashtu është, ashtu, po... ka kohë akoma!

U hap dera dhe u duk Florika me servisin e mirë të kakaos. E vuri përpara filxhanët dhe një enë të bukur tërë ornamente plot me amareta.

— Kot! — tha inxhinieri dhe diç deshi të shprehet më tej, por e rezervoi mendimin. — Gëzuar! — tha dhe rrufiti kakaon e nxehtë.

— Gëzuar të jesh e në dasmë, të keqen nëna!, —
iu përgjigj flakë për flakë e ëma e Florikës. Pastaj
u kthye prapë në temë:

— Shtëpinë zotrote brenda në qytet e ke?

— Po! tha përsëri ai, pa e shikuar fare në sy. Pas
pak shtoi: — Po së shpejti do ta kem këtu!

— Uaaa! Po pse?! — Nuk u përmbajt dot e zonja
e shtëpisë.

— Po meqenëse do të punoj këtu, shokët e këshi-
llit do të mërregullojnë edhe me shtëpi. Po të kem
edhe nënën e motrën këtu, s'kam pse iki poshtë e
lart në qytet. Nëna pensioniste është, kurse motra le
ta vazhdojë këtu shkollën e mesme bujqësore; njëlloj
është, apo jo?! — pyeti kot inxhinieri, pasi e kuptoi
se nuk u erdhi mirë.

Mëmë e bijë heshtën për një çast. Ai vazhdoi:

— Edhe ato edhe unë kemi nevojë për njëri-tje-
trin!

— Po me motrën e keni biseduar; edhe ajo është
dakord? — e ndërpreu Florika, me shpresë se te mo-
tra e tij mund të mbështeste mendimet e saj.

— Po! — tha inxhinieri. — E kemi biseduar disa
herë. Bile ajo mezi pret, pasi vitin që vjen mbaron
dhe këtu do të jetë më afër punës.

Ndërsa nënë e bijë filluan të shiheshin në
sy të ftohura nga gazi i fillimit, inxhinieri mori
pincat.

— Ne erdhëm për punë, apo jo? — pyeti duke
qeshur, me sytë te Florika.

— Posi! Ja tani! — dhe fluturoi jashtë.

— E ç'lodhesh me të zotrote, se do të fëlliqësh
duart! — tha e ëma.

Por e bija erdhi dhe e shoqëroi në sallon për te
lavatriçja.

Ai u përkul e filloi punën. Florika shihte herë atë dhe herë të ëmën, sikur t'i kërkonte ndihmë për diçka. Por e ëma ia bëri me kokë t'i rrinte përballë dhe doli për t'i lënë vetëm.

E rregulloi shpejt, po Florika s'e la të ikte pa e provuar dhe e vuri në prizë. U pa që ishte në rregull dhe ai bëri të dilte, po ajo nguli këmbë të mos e linte, se... ja, erdhi darka...

Iu lut shumë, jashtë mase, pa ai kishte ndodhur kokëngjeshur. Doli që doli. Në oborr e ëma e Florikës shprehu habinë, por ai s'ia zgjati; i dha dorën dhe i uroi natën e mirë. E lanë ta përcillte vetë Florika gjer ku, e sa të donte. Por edhe kjo s'qe e thënë! Pasi ecën nja pesëdhjetë metra dhe dolën në rrugën kryesore, nga SMT-ja po vinte një motoçikletë, e cila qëndroi afër. Inxhinieri, që njohu mekanikun e SMT-së, nxi-toi ta pyeste.

...Ishte prishur makina mbjellëse dhe duhej bërë modifikimi i një pjese këmbimi. Mekaniku priste mendimin dhe ndihmën e inxhinierit, prandaj s'kishte lënë vend pa e kërkuar.

— Makina është në arë! — tha ai. — Po ta sjellim në oficinë na pengon mbjelljet! Mendoj ta riparojmë atje.

Pa e zgjatur, inxhinieri hipi prapa motorit.

— Do të bëhesh me pluhur! — i pëshpëriti Florika në vesh, me keqardhje të shtirur, sikur s'guxonte t'ia thoshte me zë më të lartë.

— Natën e mirë! — tha ai dhe motori u nis.

Në muzgun që po binte, dritat çanë errësirën dhe ndriçuan rrugën e gjerë që të çonte përpjetë ugarëve. Prapa atij ndriçimi, inxhinieri nxitonte për atje, ku e prisnin mbjelljet e reja...

Florika e ndoqi një copë herë me sy dhe pastaj

shikoi rreth e rrotull si e trembur. Ishte e vetme, në
errësirë, fare e vetme!

Flladi i freskët i mbrëmjes iu fut në trup dhe
ndjeu rrëqethje; ndjeu të ftohtë!.. U kthye për në
shtëpi.

Te porta priste e ëma, por ajo nuk i foli. Eci
drejt, me kokën ulur dhe u mbyll në dhomën e pri-
tjes.

— Na marrtë të keqen, — tha e ëma. — Ai kër-
kon të bëhet fshatar, ndërsa unë dua të të bëj qyte-
tare, prandaj s'më duhet ai dhëndër. Mos u mërzit,
se do të gjejmë ndonjë tjetër!

— Po kur, moj mama? — u ankua Florika. — Po
më ikin vjetët...

— Le të të ikin. Ne nuk do t'i tregojmë dhëndrit
sa vjeç je, moj shpirt i mamit.

Dhe u përgatitën për të gjetur ndonjë dhëndër
tjetër.


VAZHDOJNË STUDIMET...

Sebep për këtë histori u bë një formular, që kërkonin ata të seksionit të arsimit, me të dhëna të plota për secilin mësues. Mirëpo është fundi i vitit mësimor dhe kuptohet ç'rendësi marrin të dhënat biografike tani, kur bëhen parashikimet për kuadrin e vitit të ardhshëm!

— Nuk mjafton që na mbytnë me këto shkresurina! — thotë ishmësuesi im, duke fshirë djersët, — por nuk na i dërgojnë as të sakta! — Dhe, pasi fut shaminë në xhep, mpreh lapsin e kuq. Pastaj heq viza dhe i shton formularit një kolonë të re. «Vazhdojnë studimet».

— Oj! — thotë duke e shikuar nëse e ka hequr drejt apo jo vijën; — vazhdojnë, more vëlla, vazhdojnë të lartën! E unë si ta shënoj këtu në formular shkollën time? Me të mesme?... Interesant! Edhe flasin kaq shumë për ngritjen profesionale, dhe as kërkojnë ta marrin në evidencë! Çudi, si nuk vënë një kolonë për arsimin përkatës të çdonjërit...

Ky avaz është i lashtë për ish-mësuesin tim. Shumë vite më parë ai u betua se pesëvjeçari që vin-



te do ta gjente me diplomë në xhep, të cilën do ta merrte me korrespondencë, si, plot shokë. Aq i sigurtë u tregua për këtë, saqë nuk nguroi të siguronte edhe shokët, deri edhe eprorët, të cilët e uruan të entuziazmuar. Atëherë unë e kisha mësues të klasës së dytë. Ishte djalë fare i ri. Sapo kishte mbaruar një shkollë dyvjeçare për mësues, djalë i gjallë e tërë shëndet. Po më shumë se punë e shëndet kishte llafe. Aq shumë i ndihte llafit, sa mësuesit e tjerë, të gjithë bashkë, s'ia dilnin dot atij vetëm. Kolegët ia njihnin mirë mësuesit tonë sistemin e punës. Kishte një regjim me të vërtetë të çuditshëm për të studiuar. Edhe mësues të tjerë studionin me korrespondencë, por jo si ai! Ata fillonin të studionin që në shtator për provimet e janarit. Kurse mësuesi ynë kishte borxh të mos kapte libra me dorë deri më tridhjetë e një dhjetor. Hante edhe Vitin e Ri qetë e shtruar, si e donte adeti, e fillonte me tre janar, pasi provimi i parë i këtij sesi ishte aty nga data pesë-gjashtë.

— Tri ditë studim janë boll për një inteligjent!
— sqaronte ai.

Po të kuptohemi ama, kur ulej të studionte mësuesi im, nuk kishte qysqi që ta shkulte nga vendi. Zakonisht studionin me Kolën, mësuesin e klasës së tretë. Që atëherë ka mbetur ajo shprehja në fshatin tonë «U nxifsh si Kola». Në të vërtetë mësuesi im ishte nxirë më shumë se Kola, po sesi e pse fshati e pa të udhës ta linte në harresë dhe t'ia vishte Kolës, nuk u mor vesh. E megjithëse që atëherë kanë kaluar tri dekada, ajo edhe sot, kur e sjell rasti, tregohet si barsaletë nga pleqtë e fshatit. E tregojnë edhe ish-nxënësit, që sot janë burra.

Pritën të zinj të çiliminj tërë mëngjezin sa t'u vinin mësuesit. Dy ishin të tërë: Mësuesi im dhe Kola. Prit e s'ka, prit e s'ka! Kur ora po i afrohej dhjetës, një çamarrok kishte hyrë nga dritarja e korridorit dhe hapi derën e madhe dykatëshe. Nxënësit u sulën kush të rrokte i pari zilen, që t'i binte kur ta urdhëronte mësuesi. Duke e tërhequr sa njëri, tjetri, zilja ra në dysheme me aq zhurmë, sa edhe ata pak nxënës që ishin jashtë u ngjeshën në korridor.

Në këtë kohë Kola qëllloi më i lehtë. U hodh përpjetë me tërsëllëmë dhe doli nga dera me lemërinë e njeriut që nuk di ku është, ç'po bëhet e ç'mund të bëjë.

— Po ju, more, ç'bëni këtu? — u bërtiti fëmijëve.

Po pikërisht këtu ndodhi çudia. Sapo doli plotësisht koka e Kolës në korridor:

— Auuu! Bobo nënë! — klithën fëmijët.

— Lugati! — thirrën të tjerët dhe në sekondë këmbë nxënësi s'u duk më jo në korridor po as në oborrin e shkollës. Nxënësit morën fshatin e, duke bërtitur sa u hante zëri, dhanë berihain:

— Në shkollë ka hyrë lugati!

Kola, që ende nuk po e mblydhte veten, pasi bëri dy-tre hapa pas nxënësve, i habitur nga kjo ikje e tyre rrëmbimthi, u kthye përsëri në klasë. Aty erdhi në vete duke iu marrë këmbët. Po ç'të shihte? Llamba, që në darkë e kishin mbushur plot me vajguri, tani dukej si xixëllonjë, e nxirë dhe e veshur plotësisht nga tymi, i cili vazhdonte të dilte fjolla.

Dispensat e hapura që në darkë, kishin mbetur po në ato faqe. Mbi tavolinë, tepsia ende e pambaruar me mezet e skuqura të darkës, kurse shishja e dytë kilshe i ishte afruar fundit. Kola u bë esëll dhe i erdhi inat me kolegun e tij që akoma gërhiste me këren futur në tepsia.

— Çohu, ore! Çohu, se u telendisëm! — dhe e tundi fort. Mësuesi im u hodh përperjetë. Hodhi sytë rreth e rrotull, duke i pulitur nga dielli, dhe pastaj ia nguli Kolës.

— Po ti, ç'je bërë kështu, o katran? Kazanët ke fshirë me turinj? Hajde fshihu pa dalë nga dera, se të zunë nxënësit me gurë! Se dua unë dru, që vij e studioj me ty! Ti e ke mendjen te lluçka e rakisë! — Dërdëlliste tërë nerva e buzë dhe mundohej të zhdukte gjurmët e asaj darke që u dukej se kishte ndodhur vite të shkuara. Kurse Kola rrinte si i humbur në këmbë.

— Shpejt merr masat të fillojë mësimi! — urdhëroi mësuesi im si përgjegjës që ishte.

— Ore! — u ndje më në fund edhe Kola, me një zë që dukej se vinte nga fundi i qypit. — Po e di si je bërë apo jo?! Laj sytë, se kështu edhe jot ëmë nuk të njeh! Të dy për ibret jemi bërë, po ku të lahemi thuaj? — dhe Kola u sul te shishja me shpresë se do t'ia zbardhte fytyrën ai pak ujë që ju duk në fund të saj. Por... jo! Ishte teprica e rakisë që ua nxiu faqen të dyve.

Ndërkohë mbërritën aty disa prindër të prirë nga nxënësit dhe një shok i këshillit të fshatit. Për fatin e dy mësuesve, i pari u fut shoku i këshillit, i cili pas pak doli përsëri i murrëtyer në fytyrë. Se si i bindi bashkëfshatarët e nxënësit që të largoheshin atë ditë nga shkolla, këtë mësuesi im edhe sot nuk di ta shpjegojë.

gojë. Megjithatë ngjarjes i shkuan deri në fund fshati e këshilli bashkë, dhe dy mësuesve ua ndërruan ujët...

Po sot këto gjëra ish-mësuesi im i quan çapkënllëqet e rinisë.

— Eh, po dhe të rinj kemi qenë, a derëbardhë! Aq mendonim! Të ishim sot pa!... — dhe zë e numëron sakrificat e mëdha që ka bërë për ngritjen e tij tekniko-profesionale.

Që atëherë kisha kohë pa u takuar me ish-mësuesin tim të klasës së dytë. Mirëpo kënga e thotë: «një-rëzit takohen një ditë». Ne u takuam në Universitet, para derës së katedrës ku pedagogu merrte në provim studentët me korrespondencë. Ai shërbente si mësues në shkollën e një fshati malor. Unë sapo kisha mbaruar institutin dyvjeçar dhe jepja lëndët plotësu-ese për të mbaruar Universitetin. Edhe ai kishte bërë përpara; kishte marrë maturën. Pas kësaj, kishte nisur vitin e parë në Universitet dhe kishte grisur disa palë këpucë në këtë rrugë. Si për respekt, unë i hapva vend që të hynte i pari në provim.

Megjithëse nuk e priti me qejf këtë gjë, nuk e dha veten. Kureshtja më shtyu ta shikoja nga pjesa pak e hapur e derës se si e ndiente veten me pyetjet. Po shpejt u binda se edhe aty, mësuesi im ruante të pacënuar autoritetin e një njeriu jo dosido. Për t'u përgatitur ndenji fare pak. Aq pak, sa të gjithëve sa ishim aty na bëri ta admironim.

— Pa u përgatitur fare u ngrit të përgjigjej, për nder! — tha shoku pranë meje. Po, për çudi, ai sa u përkul pak te pedagogu, i zgjati librezën, e futi në çantën lustrafine dhe, pasi veshi pardesynë e ndreqi kollaren, i tha «mirupafshim» (sikur të kishte qenë aty vetëm për një vizitë!). Pastaj mori shprehjen

e një babaxhani, që s'do t'ia dijë për këso vogëlsirash dhe doli duke buzëqeshur.

— Hë!? — pyetëm të gjithë ne që mbanim derën aty.

— Shumë mirë! — na u përgjigj ai, gjithnjë duke buzëqeshur. — Më ranë pyetje të vështira, po mirë, mirë; u përgjigja shpejt!... Pedagogu është shumë i mirë... Suksese edhe ju! — Dhe iku.

— Edhe ne?! — thashë unë me vete, i bindur se ai s'u përgjigj fare dhe dorëzoi tezën pa hapur gojën. — Edhe ne suksese si ti? — dhe e shikova nga pas. Ai zbriste shkallët rëndë-rëndë.

Kështu u takuam edhe herë të tjera me ish-mësuesin tim, po, për çudi, atë e shihja në çdo sesion tek e njëjta derë dhe tek i njëjti pedagog... Herën e fundit ia pashë emrin në listën e studentëve që përjashtoheshin për mosshlyerje të provimeve në kohë.

Kur ia thanë këtë, u hodh përpjetë:

— Në asnjë mënyrë! — tha. — Me siguri ndonjë gabim i sekretares! — Dhe mori guximin të ngjitej deri në sekretari.

— Ç'të tha? — e pyetëm njëzëri kur po zbriste.

— S'e gjeta!... S'ishte në zyrë! — na u përgjigj dhe prapë buzëqeshi, po këtë herë shumë pak. E pashë të largohej i menduar. Ndoshta ishte hera e parë që dilte nga ajo derë aq i mërzitur...

...Meqenëse kishte vend bosh në kabinën tonë, ai u ul pranë meje kur po ktheheshim me tren. Prisja të më fliste. Ai hiç. Në gjithë atë rrugë, i bëmë a s'i bëmë dhjetë llafe, edhe ato për gjëra pa rëndësi. U krodh në një raport që nxori nga çanta. E lexonte dhe ku e ku i bënte korrigjime me laps të kuq; diku i shtonte fjali të tëra. Duke e shikuar me terezi, munda të dalloja se ishte një raport i përgatitur nga ai

vetë për në mbledhjen e këshillit pedagogjik, me temën: «Ngritja ideologjike e profesionale e mësuesve — kusht me rëndësi për revolucionarizimin e procesit mësimor dhe edukativ». Ndërsa lëkundeshim nën ritmin e vrapit që kishte marrë treni; ish-mësuesi im, me vetulla të ngrysur, vazhdonte korrigjimet me ngjyrë të kuqe. Por edhe këto s'kishin mjaftuar.

Këtë ma thanë pas mbledhjes që kishin bërë, ku raportin nuk e kishte mbajtur ai, por kolegia, nëndrejtoresha e shkollës. Megjithatë s'kishte qëndruar pa folur. Veçse këtë radhë, ndoshta për herë të parë në jetën e vet iu desh të bënte vetëm autokritikë, në përgjigje të një dushi të mirë që i bënë të gjithë mësuesit.

Këtë radhë duhej t'i vazhdonte studimet me vepër, jo me fjalë.


TË FALA NGA SHEMJA

— Hë?... Si vajti puna sot?

Unë, që e di përse është fjala, ul kokën ose hedh vështrimin gjetkë dhe hesht. Ç'të bëj? Mirëpo heshtja është e papranueshme për Hankon time, prandaj ajo vazhdon ta ngrejë zërin:

— Ti e ke në dorë! Po deshe ti, ne edhe sivjet do të jemi pa një pa dy në rërën e nxehtë të detit. Kurse ti mbahesh sikur kushedi ç'do të bësh! Do të lësh në klasë Xhelon... Trimëri të madhe do të bësh!

Dhe në këtë pikë Hancoja ka të drejtë! Nuk është aspak trimëri ta lësh në klasë Xhelon e Muços. Por puna e solli që Xhelon duhej ta kaloja e jo ta lija në klasë. Mirëpo për këtë duhet një barrë trimëri. Dikujt mund t'i duket çudi, po unë e kam me gjithë mend! Më gjeni atë burrë që mund ta kalojë sot Xhelon në klasën e tetë dhe unë do ta quaj trim të madh. Se trimëria duhet të jetë e një shkalle të tillë, saqë t'u kundërvihet e t'u dalë për zot jo vetëm ndërgjegjes por edhe ligjeve të shtetit, edhe vendimit kolegjal të mësuesve që i japin mësim Xhelos, të cilët në diskutimin paraprak vendosën njëzëri:



— Xheloja mbetet! Sivjet është e pamundur ta kalojë klasën!

Dhe ja tani, dy ditë pas këtij vendimi ndodhi ajo që nuk pritej... Në një mëngjes të bukur pranvere, troket dera dhe hyn Muçoja tërë shënd e gaz. Unë e ftoj në dhomën e pritjes dhe ai ulet si në shtëpinë e tij. E dija se Muçoja është Muço, por, se një ditë do të bëhesha mik me të, kurrë s'më kishte shkuar ndër mend!

— E, ore, e! Ja kështu; ne bashkë jemi miq! Bile të afërt shumë! — kështu iu përgjigj ai pyetjes e habisë sime dhe u shtriq më mirë në kolltuk.

«Miq ne bashkë? — shpresoja se mos bënte shaka. Mirëpo Muçoja s'më la të prisja gjatë:

— Ke të fala nga Shemja! — Më tha. — Mbrëmë erdha nga Vlora dhe...

Gruaja që hyri me tabaka në dorë, sapo dëgjoji emrin e Shemes, klithi:

— Nga cili Sheme, more Muço? — Pa hë! Ç'të tha? kishte bërë gjë për atë hallin tonë apo jo?

— Për punën e plazhit? — i ra në të Muçoja. — Më tha të mos merakoseni fare se do ta rregullojë... Bile më dha edhe një pusullë për ju, shoku Gani! — e më zgjati letrën.

Hankoja u vërsul ta lexonte kurse mua s'di pse më mbetën sytë në fytyrën prej babaxhani të Muços, i cili, më krekosjen e tij, të jepte përshtypjen e njeriut që e hodhi lumin. Hankoja lexonte:

«Jemi e qofshi mirë! Fëmijët si i keni? Ah, more Gani, të kishe qëndruar edhe një çikë kur ishe këtu, do ta kishim përlarë edhe një darkë me Muçon. Sapo dole ti, ai erdhi. Apo nuk solli i uruari nja dy qillo nga ajo e shkreta... Shtatë vjeçe ishte, nëntëmbëdhjetëgradëshe. Nejse, Muçon aty e ke dhe mos

vono ta provosh vetë, që të më japësh hak, por një gjë harrova të të thosha pardje. Muçua ka aty në shkollën tuaj një djalë që... Ç'ta zgjasim. Ti e kupton vetë; djali i Muços është djali ynë! Ajo puna e plazhit, qeni qepën të hajë...»

Hankoja lexonte, mua më mbetën në mendje dy gjëra: «djali i Muços qenka djali ynë» dhe «Qeni që do të hante qepë po të mos rregullohej dot puna e plazhit tim».

Ja, pra! Papritur e pakujtuar, Xheloja i Muços u lidh me një problem timin kaq serioz! Gjithçka u bë e qartë; unë me Hankon time do ta shijonim rëren e detit, vetëm pasi të kapërcente xheloja (djali ynë) lumin për në klasën e tetë. Për Xhelon ky s'ishte lumë, po det e shkuar detit! Kurse Muçoja mendon se me këtë pusullë e gjeti varkën për të hedhur lumin e detin bashkë! Mirëpo unë për këtë punë kisha vendosur ditë më parë, duke mbështetur edhe mendimin e shokëve të mi mësues. Hankoja sikur e kuptoi sekëlldinë time dhe u sëkëlldis dyfish. Kishte hak! Edhe sivjet që e vumë në vijë punën e plazhit, na doli Xheloja përpara! Se Hankoja ime është ca terse: o shkon në plazh çdo behar, o bëji derman!

Shemen e njeh gjithë qyteti si burrë fjale, prandaj na u duk e ndrequr kjo punë. Por, siç duket, fjala u mbajtka me fjalë! Ashtu siç na dha fjalën neve për kabinën e plazhit, Shemja i ka dhënë fjalën edhe Muços se Xheloja do ta kalojë klasën e tetë.

Po kush do ta kalojë se? — pyes unë veten.

— Ti ta kalosh — më thotë Hankoja. — Ti kalojë në dy lëndët e tua e u thuaj edhe të tjerëve ta shtyjnë në të tyret! ...Oj, nuk e sheh! Sikur do të bëhet kiameti!

Hankoja flet e unë mendoj, duke qeshur me ve-

te. Mendoj për Xhelon dhe habinë e tij sikur t'i thonë: «e kalove klasën». Kurse Muçoja do t'i rrahë krahët: «Hajde qerrata!, do t'i thotë, — shoqëria e miqësia ngjitin lumin përpjetë e jo mos të të vënë një copë pesë sa për të shtyrë një klasë!...»

Kur më sheh kështu, të kredhur në të thella, Hankon e zë frika e prapë pyet:

— Hë, e pyete sot Xhelon në mësim?

— Po! — i them unë. — E pyeta! — Dhe sjell në mend vargun e katrave të Xhelos, që sa vjen e zgjattet.

— Epo, hë? — vazhdon ajo, — do të vemë sivjet në plazh?

Unë qesh e mendohem. Kujtoj punën që kam bërë bashkë me kolegët e mi për muaj me radhë për ta kaluar Xhelon. Rezultatet e kësaj pune ma forcojnë bindjen se përgjigjen pozitive të kësaj pyetjeje Hankoja do ta marrë vitin që vjen.

Dhe thuaj shyqyr që Hankoja u bind me fjalët e mia, se e dini ç'kisha menduar? Po të ngulte këmbë akoma, do ta merrja në mbledhjen e posaçme të këshillit pedagogjik, në mënyrë që, në vend të rërës e të diellit të nxehtë të plazhit, t'i bënim një dush të ftohtë.

Ç'të bëjmë, moj Hanko! kusur e patëm sivjet të mos shkojmë në plazh, me gjithë miqësinë e Shemes!

MUSTAFA BEU DHE GJYSMA E MJEKRËS

Ishte dhjetori i vitit 1923. Megjithëse dimri bënte si behar, Mustafa beu kishte kohë që s'e bënte më gjumin e mëngjesit si dikur.

«Ç'të bësh? — mendonte. — Duhet harxhuar ca për ta fituar përsëri atë qerrata kolltuk.»

Dhe çohej herët. Pa u zgjuar akoma tërë qyteti, ai nxitonte drejt kafenesë. Atje herë gjente ndonjë terjaqi kafeje, herë bënte vetë sefte.

— Shpejt e paske prishur rehatin, bej! — i thoshte kafexhiu dhe vinte xhezvenë mbi prush.

— Ç'të bësh? Punët e shtetit si ujët e detit! Me-zallah se paskan të mbaruar! Mbemë tërë ditën poshtë e përpjetë! Populli ka halle dhe, po s'ia qamë né, kush do t'ia qajë!? Ja, më shihni mua? Vërtet më janë rënduar cazë gjunjët, po puna s'më lë të rehatohem. Edhe netët po i gdhij në punë. Ja, sonte mblo-dha gjithë qehallarët e mi dhe urdhërova të shpër-ndajnë një grazhdare të tërë me misër në fshatin Biçan. E thirra edhe kryeplakun. Fukarenjve, i thashë, t'ua jepni! Po pse, do të thoni ju, ai është malli yt! E di, ore, e di! Po, për besë, kur më zuri veshi se kishte njerëz që vuanin për bukën e gojës, s'pyeta më! Ta

hajë populli thashë! Se edhe unë i popullit jam! Ja kështu!

Dhe me terezi, bënte si bënte e vërtiste muhabetin te zgjedhjet në qeveri që do të bëheshin së shpejti.

— Populli e di! — thoshte Mustafa beu. — Ai e ka parë më mirë se kush përpiket për të! Atij le t'ia japë votat!

Po të gjithë e dinin se kjo ishte sa për të larë gojën, pasi për të fituar votat beu kishte futur në punë njerëzit e tij, që në fshatrat ku punonin bujqit e tij, deri në qeveri. Në fshat valonte druri e ryshfeti për t'u dhënë votat zgjedhësve të dytë, që kishte caktuar beu me njerëzit e tij. Të tjerë merreshin me zgjedhësit e dytë. Gjithë këtë kohë ai kishte punuar për këto ditë të vështira, prandaj tani kishte shumë nga ata që përpiqeshin e shqetësoheshin për votat e tij.

Por këto kohët e fundit, deputetin veteran sikur kishte filluar ta shqetësonte qëndrimi i disa bujqve të tij, të cilët denbabaden nuk ia kishin kursyer fjalën e mirë dhe votën. Tani po e shihte se nuk ishin më ata të parët. Lufta politike në këto zgjedhje ishte ashpërsuar shumë. Kaq gjë e kuptonte beu, prandaj, pavarësisht nga sa thoshte, gjumi natën nuk e zinte.

Pasi u kthye në shtëpi për të ngrënë mëngjesin, doli aty nga ora dhjetë, për t'u hedhur edhe një sy ngjarjeve në qytet e për të marrë vesh ndonjë të re andej nga bujqit e fshatrave të tij. Duke ecur me mendjen degë më degë, i shkoi dorën mjekrës dhe pa se ishte i parruar.

«Sot duhet të rruhem! — mendoi. — Është ditë pazari dhe njeriu i qeverisë në ditë tilla duhet të shkëlqejë nga çdo anë»...

U ul në poltronën rrotulluese të berberhanes

dhe shtriu kokën pas në mbështetëse. Berberi e shkumosi dhe, pasi mprehu mirë briskun, filloi. Po beu ishte njeri zevzek, një minutë nuk i rrihej pa folur e pa lëvizur. (Vetëm në parlament thoshin se i kyçeja goja.) Kthente kokën prapa dhe bisedonte me ata që do të rruheshin pas tij. Shqetësimi për votat ia kishte bërë gojën çark e gjuhën brisk.

Berberi priste me brisk në dorë, e shkumosi për së dyti e për së treti fytyrën bullafiqe të beut dhe vazhdonte punën gjithë kujdes e merak. Në këtë çast në berberhane hyri togeri.

— Me shëndet e tungjatjeta bej!

— Tungjatjeta e mirë se vjen! — ia priti beu, pa e kthyer kokën. — Si po shkojnë punët, toger? — e pyeti në një mënyrë të tillë, nga e cila kuptohej lehtë se priste përgjigje për porosinë që kishte dhënë.

— Siç duket, akoma nuk e paske dëgjuar, bej! — tha togeri, duke i theksuar fjalët që shprehnin edhe një farë revolte.

— Ëëëë? Çfarë the, toger? — lëvizi nga kolltuku beu. Berberi u step me brisk në dorë.

— Lalëria, bej, lalëria! Janë mbledhur e po dëgjojnë nga goja e dhaskalit të tyre se bejlerët e agallarët, domethënë zotëria juaj e të tërë né, qenkemi gjakpirës! — Sa shqiptoi togeri fjalën e fundit, beu u hodh përpjetë nga kolltuku dhe u sul nga dera, pasi flaku nën këmbë peshqirin që i varej te gusha.

— Po ju ç'bëni, more toger? Po ka apo s'ka xhandarë këtu, xhanëm? Epo për çfarë tjetër na duhet kjo djall xhandërmari? Ëëëë? E ç'punë tjetër keni ju?

Berberi, pasi mbeti për një hop me brisk në dorë, u sul pas beut.

— Bej! Bobo, beu doli me gjysmën e mjekrës të parruar! — dhe mbeti i shtangur.

— Rrihet davaja e zgjedhjeve, bej, zotrote e di!

— Unë e di, e di! Po le ta dinë edhe këta harbutër. se, po nuk deshën të na i japin votat me të mirë, dimë t'i marrim edhe ndryshe. More vesh ti! Për ne, shëndoshë qeveria dhe zoti i shtoftë ymrin Zogut!... Po ju duhet ta dini ama se qeveria ju paguan aq, sa s'ju bën koka! dhe pse? Ja për këtë punë.

— Ne që andej po vijmë, bej! I provuam të dyja: edhe fjalën, edhe frikën, Por ata ishin shumë! Tani njoftova komandën eprore dhe po pres forca të reja!

— O, të preftë kolera, të preftë! Gjersa të vijnë ato forcat e tua, Naun Prifti¹⁾ e bëri punën! Ua bëri mendjen top leckamanëve, duke iu thënë se kujt duhet t'ia japin votat.

— Po është grumbulluar shumë popull, bej! S'ke ç'u bën me kaq pak xhandarë sa kemi këtu! — u shfaqësua togeri para beut deputet. Por ky u zemërua më keq.

— Ti je vetëm për llafe, more vesh? Vetëm për llafe je! Të kam thënë unë! Për oficer një lek s'bën! Oj, s'ke ç'u bën thotë! Pa të shohim, kam apo s'kam ç'u bëj, unë! Lamën! Ma thërrisni këtu Lamën!

1) Naun G. Prifti (Doko) (1898-1934), lindur në Libofshë dhe vdekur në Tbilis (Gjeorgji). Komunisti i parë i Myzeqesë, propagandist e mësues revolucionar, kundërshtar politik i regjimit të Ahmet Zogut, anëtar i organizatës «Bashkimi», luftëtar dhe udhëheqës ushtarak në Revolucionin e Qershorit 1924. Ka mbajtur disa fjalime kundër bejlerëve e regjimit në fuqi në vitet 1920-24 në qendrat kryesore të qyteteve e fshatrave të Myzeqesë.

— Urdhëro bej, urdhëro! Këtu më ke! — gjeti rastin Lamja për t'i treguar të zot se edhe në këtë ditë halli i gjendej pranë.

— Po ku je, more tutkun! Po e sheh gjithë atë mexhilis atje e s'vjen të më njoftosh?

— Peqe bej! Po do t'ju thosha sapo të mbaronit së rruari, se kushedi lëviznit dhe... brisk i thonë!

— Lëri dënglat, Lame, se nuk është koha dhe dëgjo ç'të them! Bjeri rreth e qark pazarit dhe njofto gjithë njerëzit...

— Po njerëzit janë mbledhur atje, bej!... — e ndërpreu Lamja sikur deshi t'i thoshte «Akoma s'po i sheh?»

— Prit de! Njerëzit tanë të thashë! Gjithë zotërinjtë, bejlerët e tregtarët e qytetit. U thuaj të mbyllin dyqanet e të vrapojnë këtu! Do të mbahet një fjalim me rëndësi, u thuaj, nga zotëria e tij, domethënë nga unë! More vesh? Mora thuaj!

— Peqe bej! — u kërrus Lamja.

— E, ashtu de, nisu tani me rend! Oj, po kjo kështu? — filloi të fliste beu me togerin. — Kemi faj ne, thuaj, që nuk ia mbyllëm gojën që në fillim Naun Priftit! Po mos u merakos, se së shpejti do ta kafshojë gjuhën për të gjitha sa ka thënë kundër nesh. — Dhe filloi të çapitej poshtë e lart i nervozuar.

— Për këtë jam shumë i sigurtë, bej! Atë punë e kemi biseduar! — foli togeri.

— Po kemi mbetur vetëm te llafet pa! Dhe tani dëgjo këtu!...

— Zoti ymër, o bej! — e ndërpreu Lamja, që sapo u kthye me një frymë. — Të gjithëve jua thashë fjalë për fjalë ato që më the zotrote!... Ja, disa po vijin dhe të tjerë janë mbledhur dhe po presin zotërinë tuaj!

— A e kupton tani, toger? — u krekos beu. — Tani unë do të filloj mbledhjen këtu dhe kam për ta bërë që të mos i vlejë lëkura një grosh atij dhaskalit e shokëve të tij. Tani populli po dëgjon atë... Mirë na e bënë; se mos hapi gojën njeri nga ne dhe s'na dëgjuan! Ne, që na nderon një qeveri e tërë si deputetë... Unë po filloj me këta zotërinjtë, pastaj populli, kur të më shohë e të më dëgjojë mua, do të grumbullohet këtu dhe Naun Prifti le t'u flasë gurëve e thasëve ku ka hipur.

Ti, toger, shko andej rrotull dhe mba vesh ç'thote dhaskali për votat dhe kush është më i zjarrtë ndër ata leckamanët! Shiko mos ndonjëri kundërshton shokët kur t'i thonë që të vijë këtu...

— Mirë, o bej, mirë! — mërmëriti togeri dhe iku.

— Hajde Lame, fillojmë né!

— Gati bej! Ja, urdhëroni! — dhe tregoi vendin ku po mblidheshin si me frikë e përtesë nja shtatë a tetë burra, të cilëve u shkëlqente në gjoks qosteku i sahatit.

— Zotërinj të nderuar! — iu drejtua beu atyre, pa bërë fare hyrjen e rastit. U kollit për të kruajtur zërin dhe, pasi mërmëriti me vete diçka, iu drejtua Lames: — Po këtu qenkan fare pak, o Lame!

— Si urdhëron, bej! Edhe shumë nuk janë, po mbase do të shtohen! — dhe sytë i mbetën nga rruga.

— Pa nisu andej dhe i thua j togerit të bëjë ç'të bëjë e të dërgojë këtu ndoca nga ata fukarenjtë, nga populli domethënë! — tha beu dhe iu kthye zotërinjve. — Siç po e shihni e po e dëgjoni edhe ju, more zotërinj, ai lala i Libofshës si shumë po na bie në qafë! Mirë ne, xhanëm, por e keqja është se mbledh gjithë popullin dhe u prish mendjen me ato proçkat e tij, duke zënë nëpër gojë bejlerët e agallarët, treg-

tarët e nëpunësit e shtetit për t'u treguar se kujt duhet t'ua japin votat!

— Shumë e drejtë, zoti Mustafa! Është turp i madh për në, bej!

— Mbani parasysh, zotërinj e miq, — ngriti zërin beu, duke marrë zemër nga miratimi që iu bë, — se propaganda që është duke bërë ky dhaskal vë në rrezik regjimin dhe vetë qeverinë tonë...

Po Lamja e ndërpreu pasionin e madh oratorik që kishte mbërthyer beun:

— Bej! Togeri nuk është fare andej... Pastaj... ishte zor të afroheshe atje! Disa fshatarë ishin të armatosur me pushkë...

— Si?! — shtangu beu. — Po nga shkoi togeri?

— Kushedi... Unë s'e pashë, po më thanë se iku andej nga zyra e tij.

— Ah, kopuku i dreqit! More, po thashë unë!... S'kemi xhandarmëri ne për t'i sjellë në islla këta lecekamanë! Po, po! Prandaj kanë ngritur veshët e po hedhin shqelma tani që erdhi koha e votave! Po veç në mos vajça edhe një herë në parlament; dyfishin e buxhetit do të propozoj për të forcuar xhandërmarinë! Po nejtse! Pra, zotërinj... Ouuu! More Lame!...


— Urdhëro bej! — tha Lamja me gjysmë zëri.

— More! Po këta nga humbën kështu?! Shih, shih, për allah, more Lame!...

— Po disa edhe ikën, o bej! — ia preu fjalën Lamja duke iu marrë goja, pa pasur guximin ta shikonte në sy beun, që po nxirrte shkurmë e avull nga inati.

— Ikën, o bej! Ja tek po nxitojnë... Duket që kanë shumë punë zotërinjtë. Helbete, ditë pazari sot!

— Bobo, sa frikë kanë marrë! Shiko si ikin duke kthyer kokën andej nga vjen zëri i dhaskalit... — mërmeriste beu pa genë në vete.



— Aha! Jo, jo, bej. Tani ju e dini vetë më mirë, xhanëm, po, me sa pashë e dëgjova unë, andej nuk kishte vetëm fjalë...!

Po beu nuk e dëgjonte e qëndronte si i ngrirë, me sytë ngulur andej nga bëhej mbledhja.

— Bej! Zotrote nuk ke mbaruar së rruari akoma! Faqen e ke me shkumë sapuni dhe ndonjëri mund ta marrë si shenjë lajthitjeje, se... Megjithëse kush nuk e njeh dhe e respekton zotërinë tuaj, xhanëm!

Po beu akoma s'e kishte mbedhur veten. Të gjitha sa pa e dëgjoi, filluan t'i përplaseshin në tru e në zemër si një tërsëllëmë që e bënte të dridhej pa e ditur as vetë se nga; nga inati apo nga frika...? Qëndronte në këmbë si kërcu i përcëlluar nga vetëtimja, me sytë andej nga buçiste fjala e mësuesit. Iu duk vetja qyqar, sikur gjithçka po i fluturonte nga duart... Po ia merrnin ata leckamanët që ishin mbledhur atje e dëgjonin atë mësuesin e tyre.

Befas filloi të fliste me vete, duke përsëritur fjalët e Lames.

— E dëgjon apo jo?! Ai po vazhdon!

— Kush, bej? — deshi ta qetësonte Lamja. — Po le të vazhdojë, o bej! E ç'do të bëjë, fundi i fundit? — Po beu nuk ishte i kësaj mendjeje. I hodhi Lames një vështrim të ashpër e qortues dhe bëri të ecte, pasi pyeti pa ditur se kë: «Berberi atje është?» Por, s'i bëri as dy hapa në atë drejtim dhe u kthye rrëmbimthi andej nga bëhej mbledhja. Një grup fshatarësh, kush me pushkë e kush me dru në krah, nxitonin drejt tij, duke sharë e thirrur me zë të lartë.

— Rruaj kokën, bej, kokën, pa mjekrës i bëhet halli! — i tha Lamja duke e shikuar nga pas beun, i cili u zhduk nxitimthi prapa dyqaneve...

L E N D A

Metamorfoza e dhëndrit	3
Drejtori im është në hall	12
Patat me bisht dhe patat pa bisht	17
Mësuesi dhe thesi me speca	21
Dollia e fundit	27
Qaj, se të vrava	36
O burra, se na zuri mësuesja	45
Gjuetia e fundit e dhaskal Dhimos	52
Pleqëria	61
Vazhdojnë studimet	68
Të fala nga Shemja	76
Mustafa beu dhe gjysma e mjekrës	81